

MERITOKRACIA NË KARRIERAT GJYQËSORE

MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

Ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të shkallës së parë për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë

Manual 2

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361578

SHKURTIME

| | |
|-----------------|--|
| RSh | Republika e Shqipërisë |
| GjPKKO | Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar |
| KL Gj | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KZhK | Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë KL Gj-së |
| ILD | Inspektorati i Lartë i Drejtësisë |
| ShM | Shkolla e Magjistraturës |
| GjA/GjAA | Gjykata Administrative/Apelit |

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|---|----|
| SHKURTIME | 5 |
| 1. HYRJE | 7 |
| 2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET | 9 |
| 3. PLANI I TRAJNIMIT | 10 |
| 4. MODULI I - GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR - NJË RISI E REFORMËS NË DREJTËSI | 13 |
| 4.1 PRURJET E REFORMËS NË DREJTËSI | 13 |
| 4.2 DISKUTIM NË LIDHJE ME PROBLEMATIKAT AKTUALE TË KUPTIMIT DHE ZBATIMIT TË KUADRIT LIGJOR NGA INSTITUCIONET DHE AKTORËT E SISTEMIT | 14 |
| 4.3 BAZA FILLESTARE E TË DHËNAVE MBI SITUATËN LIGJORE DHE PROCEDURALE PËRPARA HYRJES NË FUQI DHE GJATË FAZËS TRANZITORE TË ZBATIMIT TË DISPOZITAVE TË REJA LIGJORE..... | 15 |
| 5. MODULI II - KRITERET LIGJORE PËR NGRITJEN NË DETYRË PRANË GJYKATAVE TË POSAÇME GJPKKO | 16 |
| 5.1. KUADRI LIGJOR E NËNLIGJOR NË FUQI | 16 |
| 5.2. TERMI “NGRITJE NË DETYRË” | 16 |
| 5.3. KRITERET LIGJORE PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJYKATËN E POSAÇME GJPKKO..... | 17 |
| 5.4. VERIFIKIMI I PASURISË DHE FIGURËS SË KANDIDATËVE PËR NË GJYKATAT E POSAÇME PËR GJYKIMIN E VEPRAVE PENALE TË KORRUPSIONIT DHE KRIMIT TË ORGANIZUAR..... | 18 |
| 5.5. MONITORIMI I KRITEREVE LIGJORE DHE METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE | 20 |
| 6. MODULI III - KRITERET E RENDITJES SË KANDIDATËVE DHE MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËRKATËSE..... | 24 |
| 6.1. HAPAT, KRITERET DHE PËRPARËSITË E RENDITJES SË KANDIDATËVE..... | 24 |
| 6.1.1 HAPI I PARË, VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL SI KRITER DHE PËRPARËSI NË RENDITJEN E KANDIDATËVE | 25 |
| 6.1.2 HAPI I DYTË, PËRVOJA SPECIFIKE SI KRITER DHE PËRPARËSI NË RENDITJEN E KANDIDATËVE | 26 |
| 6.1.3 HAPI I TRETË, VJETËRSIA SI GJYQTAR SI PËRPARËSI NË E RENDITJEN E KANDIDATËVE..... | 26 |
| 6.2. MONITORIMI I KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE | 27 |

| | |
|---|----|
| 7. MODULI IV - PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË DHE GARANCITË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KANDIDATIT | 29 |
| 7.1 PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË DHE MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËRKATËSE | 29 |
| 7.1.1 FAZAT E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË DETYRË;..... | 29 |
| 7.1.2 VENDIMI PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE DHE VENDIMI PARAPRAK I PROPOZIMIT PËR EMËRIM. E DREJTA E ANKIMIT. | 31 |
| 7.1.3 VENDIMI PËR NGRITJEN NË DETYRË | 32 |
| 7.2. MONITORIMI I PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË DHE USHTRIMIT NGA ANA E TYRE I TË DREJTAVE PROCEDURALE | 32 |
| 8. PYETJE DHE ÇËSHTJE PËR DISKUTIM..... | 34 |
| 9. EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI..... | 36 |
| 10. BIBLIOGRAFIA..... | 50 |

1. HYRJE

Manuali i Trajnimit mbi “Ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar” vjen si një vijimësi e Guidës Monitorimi për Shoqërinë Civile “Aksesi në Drejtësi dhe Gjykimi i Drejtë”, synimi i së cilës është aftësimi i organizatave të shoqërisë civile, si aktorë aktivë të shoqërisë, që ndërmarrin nisma në kuadër të rritjes së pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies efektive, përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të pavarura të drejtësisë, me qëllim zbatimin me korrektësi të legjislacionit në fuqi nëpërmjet:

- Zhvillimit të një kornize të përgjithshme njohjeje në veprimtarinë e organeve të pavarura të drejtësisë, funksioneve, kompetencave dhe kufizimeve të tyre për sa i përket zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve përmes mekanizmit të ngritjes në detyrë.
- Ofrimit për organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve në një kornizë të përbashkët referimi, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizojnë nismat e tyre për të monitoruar me promovimin e gjyqtarëve brenda sistemit gjyqësor bazuar në kritere objektive, aftësitë profesionale dhe në meritë.

Në vijim të treguesve dhe të faktorëve të përcaktuar në Guidë, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe standardet që duhet të zbatohen për zhvillimin e një procesi të rregullt ngritje në detyrë, duke u ndalur në disa komponentë kryesorë:

Së pari, risitë e reformës në drejtësi në drejtimin e krijimit të strukturave të posaçme për luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ngritja dhe funksionalizimi i këtyre strukturave afekton jo vetëm arkitekturën e sistemit të drejtësisë në vend, por pozicionin e magjistratëve si pjesë e tyre.

Së dyti, parashtron kriteret ligjore për ngritjen në detyrë pranë këtyre gjykatave të posaçme në shkallën e parë, si dhe nxit reflektimin mbi zhvillimin e mënyrave dhe mjeteve efektive për kuptimin dhe vlerësimin e këtyre kritereve për qëllime kërkimore, monitoruese dhe advokuese;

Së treti, duke parashtruar kriteret e renditjes së kandidatëve të cilët kërkojnë të promovohen në këto struktura i shërben nevojës për meritokraci por edhe transparencë, llogaridhënie dhe pjesëmarrjes së publikut në punën e këshillave të vetëqeverisjes në sistemin e drejtësisë;

Së katërti, manuali fokusohet në detyrat e Këshillit të Lartë Gjyqësor (KLGj) për zbatimin me rigozitet, por edhe në frymën e reformës të procedurave e ngritjes në detyrë si mund të monitorohet e raportohet kjo përmes mjeteve objektive dhe të besueshme.

Në kuadrin e këtij manuali, analizat si të kuadrit ligjor si në kuptimin e rregullimit material ashtu edhe atij procedural do të shihen në dritën e praktikave të deritanishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, me qëllim dhënien e një tabloje të plotë të mënyrës së zbatimit dhe respektimit të këtyre parimeve dhe ofrimit të elementeve të referimit për monitorimin e këtyre elementeve nga aktorët e drejtësisë. Manuali do të ndahet në 4 module, ku secili modul do të strukturohet në disa aspekte, me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë komponentët e mësipërm:

Moduli i parë – do të përmbajë një prezantim mbi ndryshimet që ka sjellë reforma në drejtësi si në arkitekturën e institucioneve të drejtësisë ashtu dhe për sa i përket rolit, funksioneve dhe fushës së veprimtarisë së tyre (KLGj si një prej tyre). Krijimi i gjykatave me juridiksion të posaçëm për luftën kundër korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe pozicioni i tyre në kontekstin e ndryshimeve kushtetuese. Gjithashtu, do të analizohen vështirësitë dhe problematikat në zbatimin e legjislacionit të ri, veçanërisht sfidës për tërheqjen në këto gjykata jo thjesht gjyqtarëve që plotësojnë kriteret ligjore por gjyqtarëve më të mirë në vend dhe që meritojnë të promovohen brenda sistemit të drejtësisë.

Moduli i dytë - do të përmbajë një analizë të detajuar të kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi mbi zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve. Një prezantim të përkufizimit dhe çfarë kuptojmë me ngritje në detyrë ku futet në konceptin e promovimit dhe emërimi në funksion si gjyqtar i GjPKKO i shkallës së parë. Gjithashtu, në këtë modul do të trajtohen kriteret e ndryshme që kandidatët duhet të plotësojnë – Kontrolli i pasurisë dhe i figurës, përvoja profesionale dhe vlerësimet etike – profesionale – si parakusht për ngritjen në detyrë.

Moduli i tretë - do të përmbajë informacion të detajuar mbi hapat e përdorur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për përcaktimin dhe renditjen e kandidatëve gjyqtarë, me qëllim ngritjen në detyrë të kandidatit që plotëson më shumë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në vendimet e KLGj-së të nxjerra për zbatim të tij.

Moduli i katërt – do të përmbajë informacion mbi procedurat e ndjekura nga institucioni duke filluar nga caktimi i relatorit, veprimet përkatëse të kryera prej tij, mjetet dhe garancitë ligjore të kandidatëve për respektimin e të drejtave të tyre si dhe procedurave të ndjekura nga Komisioni vlerësues përkatës (KZhK) deri në shqyrtimin e çështjes në KLGj.

2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET

Ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit dhe thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet në të cilat bazohet promovimi i gjyqtarëve, me fokus zhvillimin e procedurave për ngritjen në detyrë nga KLGj-ja, si dhe kriteret ligjore të përdorura për renditjen e tyre deri në propozimin për emërim ose emërim të tyre.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi standardet dhe kuadrin e brendshëm ligjor dhe nënligjor në lidhje me sistemin e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve përmes njohjes së mekanizmit të ngritjes në detyrë;
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi rëndësinë e një sistemi të mirëpërcaktuar të ngritjes në detyrë;
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi institucionet përgjegjëse (Këshillin e Lartë Gjyqësor) – veprimtarinë e tyre, si në zbatimin e kriterëve të përcaktuara ligjore dhe në respektimin e procedurave dhe afateve procedurale dhe ndikimin që kanë në pavarësinë, paanësinë dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor;

Nëpërmjet gërshetimit të metodës teorike dhe rasteve praktike, do të synojmë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit ligjor të aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit për zbatimin dhe monitorimin e sistemit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të pavarura të drejtësisë (KLGj).

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile do kenë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma, në kuadër të rritjes së pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies efektive, përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë, me qëllim monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore për sa i përket zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, duke analizuar zbatimin praktik të kriterëve dhe procedurave të ngritjes në detyrë nga institucioni përgjegjës (KLGj) dhe kjo për nivele dhe gjykata të ndryshme (p.sh.. GjPKKO).

3. PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje gjysmë dite trajnimi (2 orë), sipas tabelës së mëposhtme:

| Aktiviteti | Metoda | Kohëzgjatja |
|--|---|------------------|
| <p>Moduli 1</p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen në vija të përgjithshme me synimet e reformës në drejtësi, krijimin e gjykatave me juridiksion të posaçëm për korrupsionin dhe krimin e organizuar, sistemin e ri të zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve dhe rolit të KLGj-së në procesin e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve. Gjithashtu në këtë sesion do të prezantohen dhe disa nga sfidat e hasura nga zbatimi i kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Për të lehtësuar edhe procesin e monitorimit dhe të vlerësimit të këtyre risive nga ana e pjesëmarrësve do të hartohet në formën e një ushtrimi edhe një <i>baseline</i> në lidhje me treguesit kryesorë të performancës (përpara dhe gjatë periudhës tranzitore të dispozitave të reja ligjore). Kjo analizë fillestare do t'i shërbejë edhe evidentimit të ndryshimeve në periudha të ndryshme të monitorimit të sistemit ligjor procedural të avancimit në karrierë nga ana e gjyqtarëve në strukturat e posaçme.</p> | <p>Prezantim me PowerPoint në lidhje me synimet dhe risitë e reformës në drejtësi</p> <p>Diskutime në formën e pyetjeve dhe përgjigjeve</p> <p>Prezantim metodologjik në lidhje me treguesit e performancës dhe zbatimin e tyre praktik</p> <p>Ushtrim / detyrë praktike në grupe të vogla në lidhje me hartimin e një baze të dhënash për monitorimin dhe vlerësimin karrierës së gjyqtarëve në GjKKO (GjKR)</p> | <p>30 minuta</p> |

| | | |
|--|--|------------------|
| <p>Moduli 2 Kriteret ligjore për ngritjen në detyrë dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse;</p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me përkufizimin e ngritjes në detyrë sipas legjislacionit shqiptar. Njohjen e legjislacionit parësor dhe atë dytësor që parashikon parime dhe rregulla mbi zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve si dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kandidatët gjyqtarë që synojnë ngritjen në detyrë në GjPKKO e shk 1. Përveç shtjellimit teorik të kriterëve ligjore, ky modul do të përvijojë edhe disa tregues që lidhen me monitorimin e secilit nga konceptet e parashikuara, përmes kazuseve konkrete dhe vlerësimit të tyre për secilin nga kriteret.</p> | <p>Prezantim me PowerPoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve praktike</p> <p>Diskutim në grupe të vogla për konceptet e hartuara nga legjislatori në secilin nga kriteret ligjore dhe zbatimin e tyre praktik (përvoja, pasuria, figura, vlerësimi, rivlerësimi dhe privatësia)</p> <p>Hartimi i treguesve për secilin nga konceptet sa më sipër dhe vlerësimi i tyre në kazuse të veçanta (ku plotësimi i çdonjërit nga treguesit vlerësohet me 1 (.05-pjesërisht dhe 0 - fare)</p> | <p>30 minuta</p> |
| <p>Moduli 3 Kriteret e renditjes së kandidatëve dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse</p> <p>Me anë këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me tre hapat dhe kriteret e përdorura nga Këshilli të cilat i shërbejnë Këshillit për renditjen e kandidatëve gjyqtarë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar të shkallës së parë. Mbi bazën e këtyre kriterëve do të ndërtohen edhe skenarë konkretë që lidhen me treguesit e monitorimit dhe vlerësimit të hapave konkrete.</p> | <p>Prezantim me PowerPoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve praktike</p> <p>Plotësimi i skedave të monitorimit dhe plotësimi i tyre në dy grupe: grupi 1 – vlerësimi procedurave të emërimit (moduli 3) dhe 2 – respektimi i të drejtave procedurale. (moduli 4)</p> | <p>30 minuta</p> |

| | | |
|---|--|------------------|
| <p>Moduli 4 Procedurat e ngritjes në detyrë dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse</p> <p>Me anë të këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen dhe thellojnë njohuritë në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë për gjyqtarët e Shk 1 në Gjykatën e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar dhe procedurat e ndjekura duke filluar nga veprimet e kryera nga relatori/rja, më pas nga Komisioni dhe deri në Këshill. Gjithashtu pjesëmarrësit do të njihen dhe me të drejtën për ankim të kandidatëve me qëllim respektimin e të drejtave të tyre dhe vendimin e Këshillit për emërim.</p> | <p>Prezantim i gjetjeve nga puna në grup</p> <p>Përmbledhje e indikatorëve me PowerPoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike</p> | <p>30 minuta</p> |
|---|--|------------------|

4. MODULI I

GJYKATAT E POSAÇME PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E ORGANIZUAR - NJË RISI E REFORMËS NË DREJTËSI¹

4.1 Prurjet e Reformës në Drejtësi

Në ndryshimet kushtetuese, të miratuara nëpërmjet ligjit nr. 76/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë” (të ndryshuar), ndër të tjera, në nenin 135 të saj, është parashikuar ngritja e Gjykatës së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Gjykata e Posaçme gjykon veprat penale të korrupsionit dhe të krimin të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, apo edhe akuzat ndaj ish-funksionarëve të mësipërm.

Gjyqtarët e gjykatave të posaçme emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe para emërimit i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikacione vetjake sipas ligjit.

Në dispozitat tranzitore të Kushtetutës, është parashikuar procesi i shndërrimit dhe emërtimit të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, në Gjykatën e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas nenit 135 të saj. Sipas kësaj dispozite, parashikohet se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda dhe Gjykata e Apelit për Krime të Rënda do të emërtohen, funksionojnë dhe ushtrojnë kompetencat e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, brenda dy muajve nga krijimi i Këshillit të Lartë Gjyqësor, sipas ligjit.

Në këtë rast, Kushtetuta i referohet ligjit nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”. Kushtetuta vë si kusht, që gjyqtarët në detyrë, pra Gjykatat për Krime të Rënda, duhet të japin pëlqimin për rishikimin periodik të llogarive të tyre financiare dhe të telekomunikimeve vetjake, me qëllim që të kalojnë në Gjykatën e re Antikorrupsion dhe Krimin e Organizuar.

Ligji nr. 95/2016 “Për Organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar

1. Burimi: Faqja e GJKKO https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/

korrupsionin dhe krimin e organizuar” parashikon se kompetenca lëndore e Gjykatave Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, parashikohet nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale e nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135/2 i Kushtetutës. Ky ligj përcakton juridiksionin penal të Gjykatës Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, e cila do të jetë me vendndodhje në Tiranë dhe e ushtron juridiksionin e saj penal në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Kompetenca tokësore e Gjykatës së Posaçme, për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, përcaktohet edhe në ligjin 98/2016 “Për organizimin e Pushtetit Gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”, ku përcaktohet edhe një herë që kjo gjykatë do të jetë me seli në Tiranë.

Që gjyqtarët të pranohen në Gjykatën e Posaçme Antikorrupsion dhe të Krimit të Organizuar, përpara caktimit në detyrë, duhet të nënshkruajnë një deklaratë, sipas së cilës ata dhe anëtarë të afërt të familjes së tyre pranojnë kushtet për të qenë nën mbikëqyrje mbi llogaritë financiare, komunikimet telefonike etj. Kushtet e sigurisë për besimin dhe konfidencialitetin, janë kushte strikte dhe parashikojnë kufizime të theksuara të lirisë personale/vetjake të gjyqtarëve dhe të familjarëve të tyre.

4.2 Diskutim në lidhje me problematikat aktuale të kuptimit dhe zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet dhe aktorët e sistemit

Gjykatat e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar filluan funksionimin më datë 19 dhjetor 2019 në bazë të Vendimit Nr. 286, datë 18.12.2019 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas ligjit për organizimin e pushtetit gjyqësor, parashikohet që GjPKKO do të ketë minimalisht 16 gjyqtarë. Ndryshimet e Kodit të Procedurës Penale kanë parashikuar që tashmë gjykatat, edhe ato të posaçme, gjykojnë me trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Aktualisht GjPKKO ka 10 gjyqtarë!

Burime të mbledhjes së të dhënave:

- Kërkesa me shkrim gjykatave, KLGj-së apo institucioneve të përfshira në procesin e promovimit (p.sh. organeve të vetingut, Ministrisë së Drejtësisë etj.);
- Faqet e GjKKO dhe KLGj-së;
- Raportet vjetore të KLGj-së sipas viteve;
- Monitorim i analizave vjetore të GjKKO-së;
- Monitorim i raportimit të KLGj-së në kuvend;
- Monitorim në lidhje me problematikat e funksionimit të GjKKO-së në media;
- Raporti i Progresit të BE (vjetor).

4.3 Baza fillestare e të dhënave mbi situatën ligjore dhe procedurale përpara hyrjes në fuqi dhe gjatë fazës tranzitore të zbatimit të dispozitave të reja ligjore

“Baseline” apo baza fillestare e një studimi është një përmbledhje e matjeve/vlerësimeve të një grupi specifik treguesish që janë të rëndësishëm për gjurmimin e rezultateve të ndërhyrjeve të veçanta, si ato të reformave në rastin në fjalë. Këto vlerësime fillestare bëhen zakonisht përpara apo në fazat e para të fillimit të një ndërhyrjeje apo programi monitorimi dhe vlerësimi. Është e udhës që treguesit të cilët zhvillohen gjatë vlerësimit fillestar apo *baseline* të jenë të njëjtë me ato që vlerëson përgjatë programit apo në faza të caktuara të tij. Treguesit mund të jenë sasiorë, cilësorë dhe miks. Ato hartohen duke iu përgjigjur pyetjeve të cilave kërkuesve iu lindin gjatë njohjes me kuadrin ligjor, përvojave të veçanta që lidhen me gjykatën, kërkesa apo ankesa të subjekteve të interesuara për proceset promovuese, raportimet e medias apo vetë institucioneve përgjegjëse p.sh. raportimit vjetor të KLGj-së në kuvend.

Mbi bazën e pyetjeve të ngritura në seksionin paraardhës mund të skicohet një vlerësim i bazës fillestare të të dhënave si më poshtë:

| Nr. | Treguesi | Lloji | Vlerësimi i treguesit | Burimi |
|-----|---|--------------------------|-----------------------|--------|
| 1 | Koha e ngritjes së GjKKO-së v. afateve të parashikuara nga ligji | PO/ JO | | |
| 2 | A ka gjykata numrin e gjyqtarëve të përcaktuar në ligj? | PO/ JO | | |
| 3 | Si është aktualisht përbërja e gjykatës? | X / 16 | | |
| 4 | Sa gjyqtarë u transferuan nga gjykata e mëparshme për krime të rënda (GjKR) në GjPKKO? | X / 16 | | |
| 5 | Sa gjyqtarë u promovuan në GjPKKO nga dhjetor 2019 / në vitin e fundit nga KLGj? | X / 16 | | |
| 6 | Sa procedura aplikimi për GjPKKO u hapën nga KLGj nga dhjetor 2019 / në vitin e fundit / në 2020 – 2021 – 2022? | X | | |
| 7 | Nr. i kandidatëve që aplikuan mesatarisht për një pozicion të lirë pranë GjKKO në 2020-2023? | X kandidatë për pozicion | | |

5. MODULI II

KRITERET LIGJORE PËR NGRITJEN NË DETYRË PRANË GJYKATAVE TË POSAÇME GJPKKO

5.1. Kuadri ligjor e nënligjor në fuqi

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Vendimi i KLGj-së nr. 70. datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”;
- Vendimi i KLGj-së nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- Vendimi i KLGj-së nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”;
- Vendimi i KLGj-së nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e “metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo-gjyqtarë për në gjykatën e lartë”.

5.2. Termi “ngritje në detyrë”

Sipas nenit 47 të ligjit nr. 96/2016, “Ngritje në detyrë” nënkupton kalimin nga një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë;

Me një pozicion të një niveli më të lartë ligji kupton:

- një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme;
- një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie;
- një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

Pra, në kuptimin e ligjit 96/2019, përveç rasteve të kalimit tranzitor të gjyqtarëve nga ish-

gjykata për krime të rënda (GjKR) dhe gjyqtarëve të emëruar në mënyrë të përhershme në gjykatat e apelit, emërimi si gjyqtar në GjPKKO konsiderohet si ngritje në detyrë apo promovim.

Në këtë kuptim, ngritja në detyrë është e vlefshme për këto kategori subjektsh:

1. Gjyqtarit(es) të gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm ose administrative të shkallës së parë;
2. Gjyqtarit(es) nga gjykatat e mësipërme të komanduar apo të regjistruar në skemën e delegimit;
3. Inspektorit(es) në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

5.3. Kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në gjykatën e posaçme GjPKKO

Ligji Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve dhe të Ligjit për Institucionet e Luftës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, përcakton 4 kategori të cilët kanë statusin e gjyqtarit ose ligji i jep të drejtën e promovimit apo ngritjes në detyrë e gjyqtarëve në pozicione në gjykatën e posaçme të shkallës së parë. Në dy prej pozicioneve (1 dhe 3) kandidati ushtron detyrën e gjyqtarit. Ndërsa në 2 pozicionet e tjera kandidati magjistrat ose ushtron funksione jogjyqësore pranë një institucioni apo organizata si i komanduar nga KLGj (pozicioni 2), ose është në funksionin “inspektor” pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë (pozicioni 4). Ndonëse këto pozicione nuk janë të barasvlershme, ato përcaktohen nga ligji si një nga kushtet minimale për promovim.

Duke iu referuar tabelës së mëposhtme, ligji parashikon 8 kushte kumulative të cilat kandidati për t’u ngritur në detyrë pranë GPKKO-së duhet të plotësojë për të lejuar kandidimin e tij. Kandidatët të cilët nuk plotësojnë një apo më shumë kushte nga sa më sipër nuk mund të vazhdojnë konkurrimin.

| | Pozicioni 1 | Pozicioni 2 | Pozicioni 3 | Pozicioni 4 |
|---|---|--|---|---|
| Kushtet ligjore | Gjyqtarit(es) të gjykatës së juridiksionit të përgjithshëm ose administrative të shkallës së parë | Gjyqtarit(es) të shkallës së parë të komanduar | Gjyqtarit(es) të shkallës së parë të regjistruar në skemën e delegimit; | Inspektorit(es) në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë |
| Kushti 1: Përvoja e përgjithshme si gjyqtar i shkallës së parë ose inspektor i ILD | 7 vjet | 7 vjet | 7 vjet | PO |

| | | | | |
|---|--|--|--|--|
| Kushti 2: Përvoja specifike si gjyqtar në të drejtën penale | 5 vjet | 5 vjet | 5 vjet | 5 vjet |
| Kushti 3: Vlerësimi i performancës | 2 vlerësimet e fundit – shumë mirë | 2 vlerësimet e fundit – shumë mirë | 2 vlerësimet e fundit – shumë mirë | 2 vlerësimet e fundit – shumë mirë |
| Kushti 4: Masa disiplinore në fuqi | JO | JO | JO | JO |
| Kushti 5: Anëtar(e) KLGj | JO – 3 vitet e fundit | JO – 3 vitet e fundit | JO – 3 vitet e fundit | JO – 3 vitet e fundit |
| Kushti 6: Verifikim i pasurisë dhe figurës | PO | PO | PO | PO |
| Kushti 7: Dhënie pëlqimi për kontrollin e komunikimeve /llogarive personale dhe të familjarëve | PO | PO | PO | PO |
| Kushti 8: Papajtueshmëri ambientale | JO | JO | JO | JO |
| Koha minimale në skemën e delegimit | | | 4 vjet | |

5.4. Verifikimi i pasurisë dhe figurës së kandidatëve për në gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar

Jo më vonë se 3 ditë nga ajo e njoftimit zyrtar për fillimin e procedurës së verifikimit, në rrugë elektronike, kandidati i dërgohen formularët përkatës të deklarimit të cilat depozitohen pranë zyrës së posaçme të Këshillit, pasi kandidati ka dhënë autorizimin me shkrim jo më vonë se 5 ditë nga ajo e marrjes në dorëzim.

Jo më vonë se 21 ditë nga ajo e nënshkrimit dhe dorëzimit nga kandidati dhe personat e lidhur të autorizimeve sipas pikës 2 të këtij Kreu, kandidati dorëzon të plotësuar, pranë Këshillit:

- formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatis për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë”. Deklarimi bëhet sipas përcaktimeve të neneve 3/1, 4, pika 2 e vijues të Ligjit nr. 9049/2003;

- formularin “Deklaratë e kontrollit të figurës”, i cili plotësohet sipas kërkesave të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- formularët e “Vetëdeklarimit”, të cilët plotësohen sipas kërkesave të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

Jo më vonë se 5 ditë nga dorëzimi i formularëve nga kandidatët, Këshilli ia dërgon ato Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.

Verifikimi i pasurisë dhe i figurës së kandidatit kryhet brenda 120 ditëve, nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, i cili, në përfundim të verifikimit, i dorëzon Këshillit një raport të hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë së kandidatit dhe mbi pastërtinë e figurës së tij, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidati apo institucionet shtetërore, të cilat bëhen pjesë e dosjes së kandidatit, sipas legjislacionit në fuqi.

Relatori shqyrton rezultatet e kontrollit, gjetjet dhe përfundimet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve.

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e kandidatit, relatori procedon me përgatitjen e pjesës së relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë dhe konfliktit të interesit, si dhe pastërtisë së figurës.

Nëse nga gjetjet dhe përfundimet e raportit të Komisionit të Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e kandidatit, relatori procedon me përgatitjen e relacionit mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm për sa i përket verifikimit të pasurisë e konfliktin e interesit apo verifikimit të pastërtisë së figurës, dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit, i cili vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

Skualifikimi i kandidatit, sa i përket pasurisë dhe konfliktit të interesit, vendoset nga Këshilli, duke mbajtur parasysh rrethanat konkrete dhe bazuar në parimin e proporcionalitetit, në rastet kur të dhënat e marra nga burime të ligjshme tregojnë se:

- burimet financiare të kandidatit nuk e justifikojnë pasuritë e tij;
- kandidati nuk ka deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen;
- kandidati ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve;
- kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit.

Skualifikimi i kandidatit, sa i përket pastërtisë së figurës, vendoset nga Këshilli në rastet kur të dhënat e marra nga burime të ligjshme tregojnë se kandidati:

- ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të bëra në Ligjin nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- ka qenë ose është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës.

Skualifikimi i kandidatit vendoset edhe në rastet kur kandidati:

- nuk ka plotësuar ose depozituar pranë Këshillit, formularin e deklaratës së pasurisë dhe konfliktit të interesit;
- ka refuzuar ose nuk ka depozituar të nënshkruara, pranë Këshillit, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë dhe konfliktin e interesit;
- nuk ka plotësuar ose depozituar pranë Këshillit, formularin “Deklaratë e kontrollit të figurës” dhe/ose formularët e “Vetëdeklarimit”;
- ç) ka refuzuar ose nuk ka depozituar të nënshkruar, pranë Këshillit, autorizimin për Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve që, në zbatim të Ligjit nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me pastërtinë e figurës së tij.

5.5. Monitorimi i kriterëve ligjore dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Për të lejuar kandidimin në një nga pozicionet e lira pranë GjKKO-së, duket të plotësohen 8 nga 8 kriteret e mëposhtme:

| Kandidati 1) gjyqtar në shkallën e parë 2) i komanduar min. 4 vjet 3) inspektor pranë ILD-së | 7 vjet përvojë si gjyqtar | 5 vjet përvojë në të drejtën penale | 2 vlerësime “shumë mirë” | Jo masë disiplinore në fuqi | Jo KLGj 3 vitet e fundit | Verifikim i pasurisë dhe figurës | Pëlqim për kontroll të llogarive dhe komunikimeve nga personi dhe familjarët | Kandidati nuk është në situatën e papajtueshmërisë ambientale |
|---|---------------------------|-------------------------------------|--------------------------|-----------------------------|--------------------------|----------------------------------|--|---|
| PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 | PO - 1 / JO - 0 |

Të dhëna plotësuese dhe cilësore:

Përveç monitorimit të kushteve të treguara më sipër, në formën e treguesve sasiorë, objekti i monitorimit në lidhje me promovimin në GjPKKO mund të përfshijë edhe të dhëna të tjera të cilat janë me interes për publikun dhe besimin e tij ndaj këtyre strukturave. Këto të dhëna të cilat janë edhe pjesë e rolit informues por edhe investigues si të shoqërisë civile ashtu edhe të medias kanë të bëjnë me aspekte 'jo formale' të vlerësimit të kushteve ligjore.

Disa aspekte të cilat lidhen me sa më sipër janë:

1. Pasuria dhe figura e gjyqtarit, i cili ka kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar, në vijim dhe veçanërisht si pjesë e procesit të promovimit;
2. Vlerësimi i kushteve të papajtueshmërisë ambientale në rastet e lidhjeve të ngushta apo familjare mes magjistratëve kur këto lidhje nuk janë të deklaruara apo formalizuara sipas parashikimeve ligjore.
3. Vlerësimi i sjelljes dhe etikës së gjyqtarit(es) nga pikëpamja e përdoruesve të gjykatës ku ai/ajo punon dhe përdoruesve të shërbimeve të gjykatës, kolegëve dhe bashkëpunëtorëve.

Ndonëse aspektet e mësipërme janë të diskutueshme dhe shpesh subjektive, ato ndikojnë dukshëm në perceptimin e publikut mbi meritokracinë e proceseve promovuese në një nga gjykatat më të rëndësishme në vend, por janë edhe tregues në lidhje me performacën e ardhshëm të gjyqtarit dhe gjykatës.

Të dhëna të tjera që mund të mblidhen në këtë fazë të procesit të ngritjes në detyrë janë:

- Numri i vendeve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;
- Pozicionet konkrete të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit;
- Numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë sipas pozicioneve hyrëse të përcaktuara nga ligji;
- Numri i kandidatëve për çdo pozicion;
- Numri i kandidatëve që kanë shprehur interesin për aplikim dhe që janë skualifikuar për mospërbushje të kriterëve ligjore;
- Numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet);
- Rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave;
- Kriteret ligjore që rezultojnë më problematike për t'u plotësuar në këtë fazë.

Gjithashtu duke qenë se faza e parë e përmbushjes së kriterëve të pranueshmësisë për t'u promovuar si në GjPKKO ashtu edhe në gjitha pozicionet e karrierës në sistemin gjyqësor,

mund të kenë interes monitorues por edhe nxitës të llogaridhënies nga ana e KLGj-së, si dhe institucioneve të tjera të përfshira në këtë proces, si dhe advokues për ndryshime të qasjes ndaj procesit (p.sh. proaktivitetit për plotësimin e vakancave) ose edhe ndryshimeve në nivel politikash dhe ligji (p.sh. në rastet e mungesës së interesit për të aplikuar apo mungesës së kandidaturave të spikatura nga radhët e gjyqësorit për këto gjykata).

Duke u nisur edhe nga problematikat e evidentuara si gjatë konstituimit, ashtu edhe gjatë 4 viteve të para të funksionimit të GjPKKO-së, disa çështje/indikatore për t'u thelluar apo vlerësuar më tej mund të jenë:

- Numri i shpalljeve / rishpalljeve të vendeve vakante pranë GjKKO-së, si dhe trendi sasiore i rekrutimit të gjyqtarëve pranë kësaj gjykate. Këtu mund të monitorohen edhe aktivitete apo përpjekje me natyrë ndërgjegjësuese, lehtësuese apo nxitëse të ndërmarra nga KLGj apo vetë gjykata për plotësimin e vakancave;
- Kohëzgjatja mesatare dhe specifike (rast pas rasti për çdo vakancë) që i duhet KLGj-së për shqyrtimin e kandidaturave në përgjithësi dhe kritereve ligjore të pranueshmërisë në veçanti;
- Kohëzgjatja dhe ecuria e proceseve të ndërmjetme apo atyre që nuk varen nga vetë kandidati siç janë procesi i vlerësimit kalimtar apo procesi i vlerësimit të performancës;
- Për studime të thelluara në lidhje me ndërvarësinë mes proceseve të mësipërme dhe cilësisë së kandidatëve.

Metoda për mbledhjen e të dhënave

Të gjitha të dhënat e mësipërme mund të studiohen veçmas apo së bashku sipas qëllimeve specifike, interesit apo problematikave që kërkojnë monitorim në kohë apo thellim dhe një analizë të faktorëve. Pra në varësi të qëllimit dhe interesit, shoqëria civile, media apo edhe academia mund të përdorin mjete dhe metoda hulumtimi të cilat mund të jenë sasiore, cilësore por më së shumti mikse për të përshkruar dhe sqaruar apo edhe për të zbuluar lidhje më të rëndësishme mes fenomeneve.

Për të qenë të besueshme por edhe të përdorshme nga më shumë se një përdorues, të dhënat që mblidhen në kuadrin e çështjeve apo treguesve të përmendur më sipër duhet të përfshijnë si burime zyrtare ashtu edhe burime të tjera si nga përdoruesit e gjykatës ashtu edhe nga publiku i gjerë.

Metodat e përdorura për qëllime monitorimi përfshijnë:

- Konsultim i faqes zyrtare të KLGj-së dhe ILD-së;
- Informacion zyrtar i kërkuar përmes pyetësorëve nga KLGj dhe ILD;
- Intervista eventuale me gjyqtarët dhe inspektorët që kandidojnë;

- Vëzhgime dhe intervista me burime të tërthorta si p.sh. specialistë të fushës apo njohës të kuadrit ligjor dhe praktikave të promovimit gjyqësor;
- Shfletimi i raporteve të KLGj-së, raportimeve dhe intervistave të drejtuesve apo anëtarëve si analizave vjetorë të gjykatave mund të plotësohen me studime dhe monitorime të mëparshme apo të ngjashme në tematikë.

6. MODULI III

KRITERET E RENDITJES SË KANDIDATËVE DHE MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËRKATËSE

6.1. Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

as verifikimit të kushteve të pranueshmërisë që u diskutuan në modulën e dytë, për plotësimin e vendeve në gjykatën e posaçme të shkallës së parë, përmes procedurës së ngritjes në detyrë, KLGj zbaton kriteret e parashikuara nga neni 48/9 të Ligjit Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

- a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:
 - i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;
 - ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor;
- b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;
- c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.

Procesi i renditjes së kandidatëve është edhe më i rëndësishmi pasi përtej kushteve ligjore, ky proces vlerëson meritat e secilit kandidat duke siguruar edhe emërimin e kandidatit më të mirë. Siç e parashikon edhe ligji, shqyrtimi dhe renditja e kandidaturave kryhet në 3 (tri) faza ose hapa, ku për secilën prej tyre janë përcaktuar edhe kriteret e përparësisë (shih nenin 9 më sipër). Faza pasuese e renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të fazës paraardhëse nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta. Në lidhje me zbatimin e këtyre kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë, përfshirë

këtu edhe GjPKKO-në, KLGj ka hartuar vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, për zbatim ndër të tjera të pikës 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

6.1.1 Hapi i parë, vlerësimi etik dhe profesional si kriter dhe përparësi në renditjen e kandidatëve

Në fazën e parë, renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart. Pra, si shembull, nëse për një vend vakant ka dy kandidatë, nga të cilët njëri ka dy vlerësimet e mëparshme shkëlqyeshëm dhe tjetri ka dy vlerësimet e mëparshme njërin shkëlqyeshëm dhe tjetrin shumë mirë, përzgjidhet kandidati me dy vlerësimet e mëparshme shkëlqyeshëm.

Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta (si shembull, nëse për një vend vakant, kandidati 1 ka vlerësimin e parafundit shumë mirë dhe vlerësimin e fundit shkëlqyeshëm, ndërkohë që kandidati 2, ka vlerësimin e parafundit shkëlqyeshëm dhe vlerësimin e fundit shumë mirë), për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

- a) “niveli i vlerësimit të fundit” – sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;
- b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” – sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart (për ta ilustruar me shembull, në këtë rast të dy kandidatët do të kishin vlerësimet e fundit shkëlqyeshëm dhe vlerësimin e parafundit shumë mirë, por kandidati 1 ka përvojë si gjyqtar i komanduar; në këtë rast përzgjidhet kandidati 1).
- c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” – sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart (në këtë rast, të dy kandidatët do të kishin përvojë si gjyqtarë të komanduar, por kandidati 1 ka shërbyer si gjyqtar i komanduar për 5 vite, ndërkohë që kandidati 2, ka shërbyer si gjyqtar i komanduar për 3 vite; në këtë rast do të përzgjidhet kandidati 1);
- ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” – sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart (në këtë rast, të dy kandidatët kanë kohëzgjatje të njëjta si gjyqtarë të komanduar, por kandidati 1 ka përvojë edhe si anëtar i Këshillit; në këtë rast do të përzgjidhej kandidati 1);

Vlen për t’u sqaruar se “Përvojë në pozicionet e komanduara”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit

të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, sipas pikës 2, të nenit 53, të Ligjit për Statusin; në çdo pozicion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë për interes publik, sipas pikës 7, të nenit 54, të Ligjit për Statusin; si dhe në çdo pozicion ku është komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara Ligjit për Statusin, në rastin kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit.

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive si më sipër, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli me:

- a) vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; ose
- b) vendimin nr. 102, datë 05.07.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo-gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

6.1.2 Hapi i dytë, përvoja specifike si kriter dhe përparësi në renditjen e kandidatëve

Duke iu referuar udhëzimit nr. 70/2020 të KLGj-së, për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, në rast se pas vlerësimit të bërë si më sipër, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë. Kandidati që ka përvojë profesionale specifike, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi kohëzgjatja e përvojës profesionale specifike. Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart.

6.1.3 Hapi i tretë, vjetërsia si gjyqtar si përparësi në renditjen e kandidatëve

Në rast se pas vlerësimit të bërë sipas kriterëve të mësipërme rezulton se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi zhvillimi i karrierës si gjyqtar. Kandidati me karrierë më të zhvilluar, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart. “Vjetërsi si jurist”, nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit si jurist në institucione publike, subjekte shtetërore ose private;

6.2. Monitorimi i kriterëve të vlerësimit të kandidatëve dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Në lidhje me monitorimin e kriterëve për renditjen e kandidatit për GjPKKO, mund të përdoret apo të adaptohet një skedë e ngjashme si në tabelën e mëposhtme:

| <i>Kandidati</i> | <i>Rezultati i vlerësimit të fundit profesional të kandidatit</i> | <i>Rezultati i vlerësimit të parafundit profesional të kandidatit</i> | <i>Përvoja në pozicionet e komanduar</i> | <i>Kohëzgjatja e periudhës së komandimit në vite (n.q.s. ka)</i> | <i>Magjistrati ka përvojë në skemën e delegimit</i> | <i>Magjistrati ka përvojë si anëtar i KLGj-së (përfshirë 3 vitet e fundit)</i> |
|-------------------------|--|--|---|---|--|---|
| <i>Pikët</i> | <i>Shkëlqyeshëm; Shumë mirë</i> | <i>Shkëlqyeshëm; Shumë mirë</i> | <i>PO / JO</i> | <i><1 1-3 4-6 7-10</i> | <i>PO / JO</i> | <i>PO / JO</i> |

Në lidhje me monitorimin e proceseve të renditjes së kandidatëve, është e rëndësishme të kuptohet radha e përparësisë së kriterëve ku së pari renditet vlerësimi etik dhe profesional. Vetëm kur ky kriter nuk prodhon një kandidat fitues, kalohet në kriterin tjetër që është përvoja profesionale e kështu me radhë, në hapin e dytë dhe të tretë të renditjes.

Megjithëse nga pikëpamja formale monitorimi i kriterëve të renditjes është pjesa më e rëndësishme sepse përcakton edhe kandidatin e renditur më lart, nga perspektiva e interesit të publikut ka disa tregues të tjerë të cilët duhet të merren parasysh. Ndër të tjera mund të përmendim:

- Zbatimi i rregullave për konfliktin e interesit dhe përjashtimin e personit nga procesi i vendimmarrjes sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Kohëzgjatja dhe prioritizimi i vlerësimeve etike dhe profesionale si të magjistratëve ashtu edhe gjyqtarëve të komanduar kur ky vlerësim mungon ose nuk është bërë asnjëherë.
- Respektimi i rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative në lidhje me njoftimin mbi të gjitha vendimet e KLGj-së apo komisionit përkatës në lidhje me procesin e renditjes, si dhe të drejtën e ankimit kundër këtyre vendimmarrjeve.

Metodat e përdorura për qëllime monitorimi përfshijnë:

- Informacion zyrtar i kërkuar përmes pyetësorëve nga KLGj-ja;
- Intervista eventuale me gjyqtarët dhe inspektorët që kandidojnë;
- Vëzhgime dhe intervista me burime të tërthorta si p.sh. specialistë të fushës apo njohës të kuadrit ligjor dhe praktikave të promovimit gjyqësor;
- Shfletimi i raporteve të KLGj-së, raportimeve dhe intervistave të drejtuesve apo anëtarëve si analizave vjetore të gjykatave mund të plotësohen me studime dhe monitorime të mëparshme apo të ngjashme në tematikë.

7. MODULI IV

PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË DHE GARANCITË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KANDIDATIT

Ky modul do të përmbajë informacion mbi procedurat e ndjekura nga institucioni duke filluar nga caktimi i relatorit, veprimet përkatëse të kryera prej tij, mjetet dhe garancitë ligjore të kandidatëve për respektimin e të drejtave të tyre, si dhe procedurave të ndjekura nga Komisioni vlerësues përkatës (KZhK) deri në shqyrtimin e çështjes në KLGj.

7.1 Procedurat e ngritjes në detyrë dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse

7.1.1 Fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë

Ngritja në detyrë kalon në disa faza procedurale duke filluar me caktimin e relatorit, veprimet procedurale verifikuese, shqyrtimi dhe miratimi i tyre nga KZhK dhe Këshilli (KLGj)

A. Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit

Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

Në rastin e GjPKKO-së, e cila e ka të përcaktuar fushën specifike në të drejtën penale, ka më shumë se një pozicion të lirë, Këshilli kryen vetëm një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë.

B. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë zhvillohet paralelisht:

- a) me procedurat e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë (shih moduli 2);
- b) me procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë, të cilët kanë qenë të komanduar në një institucion brenda sistemit të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tyre etik dhe profesional (shih moduli 3).

Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

Detyrat e relatorit nga pikëpamja procedurale e zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë lidhen me:

- a) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjenden në dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes;
- b) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e veprimeve të kryera dhe të dokumenteve të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për renditjen e kandidatëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;
- c) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim;
- d) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
- e) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
- f) njoftimet për kandidatët veçanërisht në rastet kur nevojiten sqarime të mëtejshme ose plotësim i dokumentacionit.

Relatori mund të kërkojë informacion relevant në lidhje me kandidatin si nga subjekte publike ashtu edhe nga ato private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sqarime, të dhëna ose kopje të dokumenteve të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.

Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve.

C. Shqyrtimi dhe miratimi nga KZhK i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim

Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke marrë masa për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve

procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve.

Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe dokumentacioni përkatës i kandidatëve është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e procedurës apo të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet procedurale dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

D. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli

Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke u dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, u njoftohet kandidatëve.

Pas prezantimit të veprimeve procedurale, gjetjeve dhe raportit të relatorit, pyetjeve dhe komenteve nga ana e anëtarëve, Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) plotësinë e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori dhe plotësinë e dokumentacionit të nevojshëm për renditjen e kandidatëve. Në rastet kur Këshilli evidenton mangësi në dokumentacion, ai ngarkon relatorin të marrë masa për plotësimin sa më parë të mangësive të evidentuara dhe cakton seancën e radhës, që caktohet jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i relatorit, ky i fundit paraqet para Këshillit aktet shtesë.
- b) miratimin e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime sipas propozimeve të çdo anëtari.

Në përfundim të bisedimeve, Këshilli voton projektvendimin e renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim. Anëtarët votojnë në të njëjtën kohë. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

7.1.2 Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim. E drejta e ankimit.

Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim arsyetohen nga relatori, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtarëve të Këshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në votim. Vendimi i arsyetuar i Këshillit iu njoftohet kandidatëve.

Kundër vendimit të Këshillit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën

Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim, bëhen publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

7.1.3 Vendimi për ngritjen në detyrë

Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori i asaj procedure, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart. Në rastin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në GjKKO, për më shumë se një pozicion të lirë, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në ato pozicione të lira të kandidatëve të renditur më lart. Vendim i Këshillit për ngritjen në detyrë i njoftohet kandidatit të ngritur në detyrë, gjykatave respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

7.2. Monitorimi i procedurave të ngritjes në detyrë dhe ushtrimit nga ana e tyre i të drejtave procedurale

- Veprimet procedurale të relatorit në lidhje me administrimin e dosjes, përgatitjen e relacionit, projekt vendimit, koordinimit të brendshëm dhe njoftimit.
- Evidentimi i rasteve të deklaruara apo jo të konfliktit të interesit dhe veprimet e ndërmarra nga relatori, komisioni dhe këshilli për rastin në fjalë.
- Evidentimi i rasteve kur evidentohet informacion i paplotë në dosjen e kandidatit dhe komunikimeve me relatorit dhe kandidatit.
- Kohëzgjatja e veprimeve procedurale nga ana e relatorit nga fillimi i procedurës së kandidimit deri në përfundim të procedurës së përzgjedhjes.
- Koha në dispozicion për njohjen e çështjes nga komisioni dhe nga këshilli.
- Afatet e njoftimit të datës së mbledhjes së Këshillit dhe relacionit të përgatitur nga relatori kandidatëve.
- Afatet për shqyrtimin e dokumentacionit plotësues, datës së seancës shtesë dhe procedurës së votimit të projekt vendimit nga këshilli.
- Afatet e publikimit të vendimit paraprak për emërim nga KLGj në faqen e internetit.

Monitorimi i respektimit të afateve procedurale të shqyrtimit të dokumentacionit të kandidimit nga relatori

- Respektimi i afatit 7-ditor për caktimin e relatorit: PO/JO;
- Respektimi i afatit 5-ditor për dhënien e sqarimeve dhe bërjen e plotësimeve në dosje nga ana e kandidatit PO/JO;
- Respektimi i afatit 7-ditor për seancën e plotësimit të dokumentacionit nga relatori PO/JO;
- Respektimi i afatit 10-ditor për arsyetimin e vendimit nga relatori PO/JO.

Monitorimi i respektimit të afateve të ankimit

- Monitorimi i afatit 5-ditor të ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit;
- Monitorimi i kohëzgjatjes së shqyrtimi gjyqësor administrativ 2-javor;
- Afatet e rishikimit të vendimit nga ana e KLGj-së në rastet e pranimit të ankimit nga GjAA-së (2 javë).

8. PYETJE DHE ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Moduli 1: Pyetje në lidhje me treguesit e monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor

Disa nga treguesit për monitorim në lidhje me zbatimin e kuadrit të posaçëm ligjor në lidhje me GjPKKO-në mund të hartohen përmes pyetjeve të mëposhtme:

1. A u krijua GjKKO-ja brenda periudhës tranzitore të parashikuar nga ligji?
2. A e ka gjykata numrin e gjyqtarëve të përcaktuar në ligj?
3. Si është aktualisht përbërja e gjykatës?
4. Sa gjyqtarë u transferuan nga gjykata e mëparshme për krime të rënda (GjKR) në GjPKKO?
5. Sa gjyqtarë u promovuan në GjPKKO nga dhjetor 2019 / në vitin e fundit nga KLGj?
6. Sa procedura aplikimi për GjPKKO-në u hapën nga KLGj nga dhjetor 2019 / në vitin e fundit / në 2020-2021-2022?
7. Sa kandidatë aplikuan mesatarisht për një pozicion të lirë pranë GjPKKO-së në vitet 2020-2023? X kandidatë për pozicion

Moduli 2: Pyetje në lidhje me treguesit e monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor

1. Cilat janë kushtet që kandidati, për t'u ngritur në detyrë pranë GPKKO-së, duhet të plotësojë për të lejuar kandidimin e tij?
2. Sa është numri i vendeve të lira në fillim dhe në fund të periudhës së monitorimit?
3. Sa është numri i gjyqtarëve të ngritur në detyrë sipas pozicioneve hyrëse të përcaktuara nga ligji?
4. Sa është numri i kandidatëve për çdo pozicion? Sa prej tyre janë skualifikuar për mospërbushje të kriterëve ligjore?
5. Sa është numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet)?
6. Cilat janë rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave?
7. Cilat nga kriteret ligjore rezultojnë më problematike për t'u plotësuar në këtë fazë?

Moduli 3: Pyetje dhe shembuj në lidhje me hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

1. Cilat janë hapat dhe përparësia që vendos ligji në lidhje me renditjen e kandidatëve?
2. Renditni sipas përparësisë: vjetërsinë në punë, vlerësimin etik dhe profesional, përvojat e veçanta të punës si gjyqtar dhe ato profesionale në fushën penale?
3. Çfarë kuptojmë me “Përvojë në pozicionet e komanduara”?

Shembull 1: dy kandidatë kanë vlerësimet e fundit shkëlqyeshëm dhe vlerësimin e parafundit shumë mirë, por kandidati 2 ka përvojë si gjyqtar i komanduar, ndërsa gjyqtari 1 ka 5 vjet më shumë përvojë profesionale. Cili nga kandidatët do të renditet më lart?

Shembull 2: Cili nga kandidatët do të renditet më lart?

- Kandidati 1 ka një vlerësim shkëlqyeshëm dhe një vlerësim shumë mirë, ka përvojë 3 vjet i komanduar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe vjetërsi në punë 10 vjet.
- Kandidati 2 ka dy vlerësimet e fundit shkëlqyeshëm, nuk ka përvojë komandimi, ka përvojë në punë si gjyqtar 15 vjet.

Moduli 4: Procedurat e ngritjes në detyrë, garancitë për kandidatin

1. Cilat janë fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë? Kush është aktori (ët) që luan rolin kryesor në secilën nga këto faza?
2. Në cilat nga fazat e mësipërme kandidati mund të ushtrojë të drejtën e ankimit dhe para cilës instancë administrative apo gjyqësore?

9. EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

9. 1. KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (*Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.1.2007, nr. 9904, datë 21.4.2008, nr. 88/2012, datë 18.9.2012, nr. 137/2015, datë 17.12.2015, nr. 76/2016, datë 22.7.2016, nr. 115/2020, datë 30.7.2020*)

PJESA E NËNTË GJYKATAT

Neni 135 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.

2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.

3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.

4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

Neni 143 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit.

Neni 147 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 147/a 34 (Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit; ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

9.2 LIGJ Nr. 115/2016 PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Neni 61 Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në komisione ose në mbledhje plenare. Kompetencat e Këshillit që nuk përmenden në pikën 2, të këtij neni, ushtrohen nga komisionet. Kompetencat që përmenden në pikën 2, të këtij neni, ushtrohen nga mbledhja plenare, bazuar në propozimet e komisioneve përkatëse.

2. Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ushtron kompetencat e mëposhtme: a) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike; b) miraton akte për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit; c) emëron dhe ngre në detyrë gjyqtarët mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës; ç) vendos masën disiplinore të shkarkimit mbi gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me dy të tretat e votave mbi propozimin e Komisionit Disiplinor; d) shqyrton ankimet kundër vendimeve të komisioneve, me përjashtim të atyre vendimeve që rrëzojnë vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimeve ose pushimin e hetimeve, sipas pikës 14, të nenit 62, të këtij ligji; dh) miraton udhëzime të përgjithshme jodetyruese; e) miraton rregulla të detajuara për funksionimin e

administratës së Këshillit; ë) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për veprimtarinë e tyre.

3. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit. Një anëtar i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare për çështje të mëposhtme të rendit të ditës: a) në rast vendimi për çështje disiplinore, kur anëtari ka paraqitur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor; b) nëse si anëtar i komisionit ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 62, të këtij ligji.

Neni 62 Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime në fushat e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit, sipas nenit 61 të këtij ligji.

2. Pasi zgjedh Kryetarin, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Në çdo rast një anëtar gjyqtar mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar gjyqtar. Një anëtar jogjyqtar mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar jogjyqtar. Procedura dhe kritere më të hollësishme për marrjen e këtij vendimi rregullohen nga Këshilli.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë: a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; b) Komisioni Disiplinor; c) Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale; ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

4. Çdo Komision përbëhet nga tre anëtarë. Pranë çdo komisioni caktohen edhe 2 anëtarë zëvendësues. Caktimi i anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të komisioneve bëhet duke mbajtur parasysh nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë, të parashikuara në pikat 5 deri në 12, të këtij neni, dhe, për aq sa është e mundur, preferencat e anëtarëve.

5. Një anëtar i Këshillit mund të jetë anëtar në jo më shumë se 2 komisione të përhershme. Një anëtar i Këshillit nuk mund të jetë kryetar në më shumë se 1 komision të përhershëm. Ky rregull nuk zbatohet për anëtarët zëvendësues dhe për komisionet ad hoc.

6. Komisionet zgjedhin kryetarët përkatës në mbledhjen e tyre të parë me shumicë votash dhe bazuar në propozimin e Kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është kryetar i komisioneve ku ai merr pjesë.

7. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

8. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar.

9. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.
10. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.
11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.
12. Anëtarët e komisioneve i ushtrojnë funksionet e tyre pranë komisioneve për dy vite e gjysmë nga dita e zgjedhjes. Në përfundim të kësaj kohe përbërja e komisioneve ndryshohet sipas procedurës të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.
13. Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit.
14. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta.
15. Komisionet vendosin me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.
16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 63 Relatori

1. Në të gjitha rastet kur mbledhja plenare ose komisionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor shqyrtojnë dhe miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të 36 gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, njëri nga anëtarët e komisionit shërben si relator. 2. Secili nga anëtarët e komisionit, përfshirë edhe kryetarin e komisionit, mund të jetë relator. Relatori caktohet me short, duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar sipas procedurës dhe rregullave më të hollësishme të miratuara nga Këshilli. Kryetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.
3. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedimit administrativ individual dhe sidomos për sa më poshtë: a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga subjektet e procedurës administrative; b) përgatitjen e projektaktit administrativ; c) koordinimin me kryetarin e komisionit për përgatitjen e mbledhjes së komisionit; ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit; d) njoftimet për subjektet e procedimit administrativ.
4. Në ushtrimin e përgjegjësisë së tij relatori ndihmohet nga personeli administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 65 E drejta për të kërkuar informacion

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor duke i vënë në dispozicion informacione ose dokumente, të cilat i nevojiten Këshillit për ushtrimin e funksioneve të tij. 2. Çdo organ publik, person fizik ose juridik paraqitet ose dërgon përfaqësues në mbledhjet plenare ose të komisioneve të Këshillit për të paraqitur prova dhe dëshmuar në lidhje me çdo çështje që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

SEKSIONI 2 MBLEDHJA PLENARE E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 66 Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mbledhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 1 herë në muaj.

2. Kryetari i Këshillit vendos për datën dhe orarin e mbledhjeve.

3. Kryetari mund të thërrasë mbledhje të tjera kur ai vlerëson se ato janë të nevojshme për veprimtarinë e Këshillit.

4. Mbledhja e Këshillit mund të thirret edhe me kërkesën e jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit, të cilët përcaktojnë në kërkesë edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Kryetari vendos datën dhe orarin e mbledhjes jo më vonë se 7 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.

5. Kryetari siguron respektimin e procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhjeje të Këshillit.

6. Njoftimi shoqërohet me rendin e ditës, projektvendimet që propozohet të merren gjatë mbledhjes, së bashku me çdo të dhënë, projektakt, këshillë ligjore, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim në mbledhje apo i cili u shërben diskutimeve në mbledhje.

7. Rregullat e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, nuk përbëjnë pengesë për të miratuar kërkesa për ndryshimin e përmbajtjes së një projektvendimi që shoqëron rendin e ditës.

8. Çdo vendim i Këshillit, që përbën akt administrativ individual në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, nënshkruhet nga çdo anëtar i pranishëm në mbledhje, siç është rënë dakord. Refuzimi i një anëtari për të nënshkruar përmbajtjen e vendimit nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e aktit. Aktet e tjera nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit.

9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në pakicë mund të kërkojë që opinioni i tij t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit.

Neni 67 Rendi i ditës

1. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor vendos rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit.
2. Një çështje e caktuar i shtohet rendit të ditës kur kjo i kërkohet me shkrim Kryetarit jo më vonë se 4 ditë përpara mbledhjes nga të paktën 3 anëtarë të Këshillit.
3. Nëse të paktën 6 anëtarë të pranishëm në një mbledhje të Këshillit vendosin se një çështje, e cila nuk ishte përfshirë në rendin e ditës, duhet të diskutohet, si dhe t'i jepet zgjidhje në mbledhje, çështja i shtohet rendit të ditës.

Neni 68 Kuorumi dhe vendimmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor

1. Pjesëmarrja në mbledhjet plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme. Në çdo rast, kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është kur në to marrin pjesë jo më pak se 7 anëtarë.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.
3. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhje, nuk mund të heqë dorë nga votimi, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa ligjore të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera në zbatim të këtij ligji, të ligjit për konfliktin e interesave ose të Kodit të Procedurave Administrative.
4. Administrata mban shënim e regjistron votat e anëtarëve të Këshillit.
5. Kryetari është anëtari i fundit, i cili voton në lidhje me një çështje.
6. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.
7. Çdo anëtar i Këshillit mban përgjegjësi për votën dhe ka të drejtë të bëjë një deklaram të shkurtër me gojë ose me shkrim për arsyet e votimit.

Neni 69 Dokumentimi i mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Kryetari është përgjegjës për të siguruar që administrata të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes: a) regjistrimit audio; b) procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve.
2. Regjistrimi audio i mbledhjes plenare bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes. Përpara publikimit, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

3. Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse e Këshillit. Edhe në këtë rast, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

4. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit, administrata mban procesverbalin me përmbledhjen e diskutimeve të çdo mbledhjeje, duke shënuar të paktën informacionet e mëposhtme: a) anëtarët e pranishëm në diskutim për çdo çështje të rendit të ditës; b) çështjet e rendit të ditës, përfshirë çështjet e shtuara sipas nenit 67, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji; c) dorëheqjet e anëtarëve të Këshillit dhe arsyetimet përkatëse; ç) aspektet kryesore të çështjeve të diskutuara dhe propozimet për vendime; d) rezultatin e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar; dhe dh) vendimet.

5. Procesverbalet me draftin e përmbledhjes së diskutimeve të mbledhjes nënshkruhen nga kryetari dhe u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve brenda 5 ditëve nga dita e mbledhjes.

6. Çdo anëtar i Këshillit që ishte i pranishëm në mbledhje mund të vërë në dukje pasaktësi në përmbajtjen e procesverbalit të përmbledhur dhe t'i kërkojë kryetarit, me anë të një kërkesë me shkrim, korrigjimin e tij. Në qoftë se regjistrimi konfirmon pasaktësinë e zbardhjes, përmbledhja e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit korrigjohet në mënyrat e mëposhtme: a) me urdhër të kryetarit, bazuar në kërkesën e paraqitur, sipas pikës 6 të këtij neni; ose b) me vendim të Këshillit në mbledhjen pasuese.

7. Administrata merr masat që regjistrimet audio të mbledhjeve të Këshillit dhe procesverbali i përmbledhur të ruhen për jo më pak se 10 vjet, në përputhje me ligjin "Për arkivat".

Neni 70 Zbatimi me analogji i rregullave për komisionet e Këshillit 1. Rregullimet e neneve 66 deri 69, të këtij ligji, për thirrjen e mbledhjes, rendin e ditës, kuorumin, vendimmarrjen dhe dokumentimin e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet përkatëse, edhe për mbledhjet e komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e komisioneve.

9.3 LIGJI Nr. 96/2016 PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 1 Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre;

2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.

KREU II PAPAJTUESHMËRITË, KUFIZIMET DHE VEPRIMTARITË E TJERA

Neni 6 Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit

1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me: a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike; b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.

2. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshime të bazuara për të besuar se një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk i përmbush kërkesat e kësaj dispozite.

PJESA III

ZHVILLIMI I KARRIERËS SË MAGJISTRATËVE

KREU I

REKRUTIMI I KANDIDATËVE MAGJISTRATË

Neni 28 Kriteret e pranimit në formimin fillestar

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) është shtetas shqiptar;

c) ka përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë "Master i shkencave", si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Europian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;

ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat ose organizatat ndërkombëtare;

d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;

dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;

e) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;

ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

KREU V NGRITJA NË DETYRË

Neni 47 Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë

1. “Ngritja në detyrë” është kalimi nga: a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë; b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme; c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie; ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale: a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë

së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse: a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si: i) përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit; ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë; iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

Neni 48 Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara

1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.

3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë: a) magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur; b) magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur; c) juristi i spikatur, sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.

4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

5. Në zbatim të pikës 3, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë: a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës; b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit; c) procedurën e kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati

kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës.

7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor; b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.

10. Këshillat vendosin të ngrënë në detyrë kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta të arritura, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14, të këtij neni. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kriterëve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni.

12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare. Vendimi i këshillave për mosçaktivimin në detyrë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme është i formës së prerë.

13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës.

14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që ndiqet në rastin e pikëve të barabarta; ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

9.4 LIGJI Nr. 98/2016 PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 3 Llojet e gjykatave

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë mund të kenë degë.
3. Gjykata të posaçme janë: a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit; b) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.
4. Gjykata e Lartë gjykon çështje të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

KOMPETENCAT TOKËSORE DHE JURIDIKSIONALE TË GJYKATAVE

Neni 11 Kompetencat tokësore të Gjykatës së Posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar

Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar organizohen dhe funksionojnë për të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në Tiranë.

KOMPETENCAT E ORGANEVE TË ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 36 Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në kompetencë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, të cilat lidhen me administrimin gjyqësor, sipas kompetencave të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Neni 46 Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që: a) t’i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara; b) t’i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik; c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik; ç) të sigurohet informacion,

në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore; d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

2. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

3. Shërbimi i marrëdhënieve me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënieve me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

4. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Shërbimet e marrëdhënieve me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.

Neni 6 Procedura e verifikimit të kushteve të sigurisë përpara emërimit në detyrë

1. Kandidati për gjyqtar dhe nëpunës civil gjyqësor në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimin të organizuar, për prokuror dhe personel administrativ në Prokurorinë e Posaçme, dhe për drejtor dhe hetues në Byronë Kombëtare të Hetimit duhet të plotësojë kushtet e sigurisë përpara se të caktohet apo punësohet në një nga këto pozicione. Asnjë kandidat nuk mund të caktohet në detyrë ose të punësohet pa plotësuar këto kushte. Të njëjtat kushte duhet të plotësohen nga çdo punonjës i Prokurorisë së Posaçme dhe Byrosë Kombëtare të Hetimit, të cilët kryejnë funksione hetimore ose funksionet e të cilëve mbështesin drejtpërsëdrejti hetimin. Kushtet e sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit janë: a) kontrolli i verifikimit të pasurisë dhe të figurës; b) dhënia e pëlqimit për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën kandidati plotëson dhe nënshkruan një deklaratë me shkrim, sipas shtojcave B1 dhe B2 të këtij ligji; si dhe c) dhënia e pëlqimit prej anëtarëve të afërt të familjes për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, për të cilën anëtari i afërt i familjes plotëson dhe nënshkruan një deklaratë me shkrim, sipas shtojcës B3 të këtij ligji.

2. Kandidati, bashkë me kërkesën për aplikim, plotëson dhe dorëzon deklaratat e kontrollit të pasurive dhe të konfliktit të interesit pranë institucioneve përkatëse të emërtesës. Nëse, gjatë 180 ditëve para se të paraqiste kërkesën, kandidati ka kaluar një kontroll të kryer prej Inspektoratit të Lartë të Kontrollit dhe Deklarimit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, i cili nuk ka rezultuar në disfavor të tij, atëherë ky kriter do të konsiderohet si i përmbushur.

3. Kandidati plotëson deklaratën e kontrollit të figurës, sipas shtojcës A, të këtij ligji, dhe e dorëzon atë tek institucionet e emërtesës.

4. Kandidati dhe anëtarët e afërt të familjes plotësojnë dhe nënshkruajnë vetëdeklarimin, sipas shtojcës B3, të këtij ligji, sipas së cilës, nëse caktohet në detyrë apo punësohet, telekomunikimet e tyre, si dhe llogaritë bankare do të jenë objekt vëzhgimi, si dhe heqin dorë nga e drejta e jetës private lidhur me këto komunikime, si dhe i dorëzojnë ato tek institucionet e emërtesës.

5. Gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit krijojnë Komisionin e Posaçëm të Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve për të bërë verifikimin e kushteve të sigurisë para caktimit në detyrë ose emërimit, të përbërë nga: a) dy prokurorë të Prokurorisë së Posaçme, të zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit; b) një gjyqtar të gjykatave të posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar, i zgjedhur me short. Procesi i përzgjedhjes me short monitorohet nga Avokati i Popullit; c) një punonjës i seksionit të hetimit financiar pranë Prokurorisë së Posaçme, i caktuar nga Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme; ç) një hetues i Byrosë Kombëtare të Hetimit, i caktuar nga Drejtori i Byrosë Kombëtare të Hetimit.

6. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës së Kandidatëve, pasi merr nga institucionet përkatëse të emërtesës deklaratat, sipas pikave 2, 3 dhe 4, të këtij neni, kryen verifikimet e nevojshme për pasurinë dhe figurën dhe, brenda 120 ditëve, i dorëzon institucionit të emërtesës një raport të hollësishëm mbi ligjshmërinë e burimeve të pasurisë dhe pastërtinë e figurës, si dhe çdo dokumentacion tjetër mbështetës të paraqitur nga vetë kandidatët apo institucionet shtetërore, të cilat bëhen pjesë e dosjes së kandidatit, sipas legjislacionit në fuqi. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, përveç dokumentacionit të paraqitur nga vetë kandidatët, mund të kërkojë të dhëna ose informacione zyrtare nga çdo institucion shtetëror në lidhje me kandidatët. Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve u kërkon informacion institucioneve shtetërore, objekti i ligjshëm i veprimtarisë së të cilave lidhet me hetimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi pasurinë dhe figurën e individit, duke i caktuar detyra konkrete dhe afate për përmbushjen e tyre. Institucioni shtetëror përkatës është i detyruar që të paraqesë informacionin ose dokumentacionin e kërkuar brenda 15 ditëve nga data e njoftimit. Këto akte bëhen pjesë e dosjes së kandidatit dhe trajtohen në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Të dhënat dhe informacionet zyrtare mund t'i vihen në dispozicion kandidatit, mbi bazën e një kërkesë të arsyetuar dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për informacionin e klasifikuar. Në rast se përhapja e informacionit apo dokumenteve cenon informacionin e klasifikuar sekret apo sigurinë publike, atëherë Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe të Figurës së Kandidatëve, pasi njihet me to, nuk i përfshin në dosjen individuale të kandidatit dhe është i detyruar të ruajë konfidencialitetin mbi përmbajtjen e tyre.

10. BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
- Ligji nr. 96/2016 “Për Statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Vendim Nr. 286, datë 18.12.2019 “Për fillimin e funksionimit të Gjykatave të Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”
- Vendim nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve”
- Vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”
- Vendimi i KLGj-së nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”
- Vendimi i KLGj-së nr. 102, datë 05.07.2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”
- Vendimi i KLGj-së nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e “metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo-gjyqtarë për në gjykatën e lartë”.
- Vendimi i KLGj-së nr. 70. datë 07.02.2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”
- Faqja e GjKKO-së: https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/
- https://www.gjp.gov.al/Gjykata_e_Posacme/Organizimi_dhe_struktura/Personeli_dhe_organigrama/

NGRITJA NË DETYRË E GJYQTARËVE
NË GJYKATËN E LARTË

SHKURTIME

| | |
|------------|--|
| GjL | Gjykata e Lartë |
| KL Gj | Këshilli i Lartë Gjyqësor |
| KZkK | Komisioni i Zhvillimit të Karrierës pranë KL Gj-së |
| KLP | Këshilli i Lartë i Prokurorisë |
| ILD | Inspektorati i Lartë i Drejtësisë |
| ShM | Shkolla e Magjistraturës |
| GjA / GjAA | Gjykata Administrative/Apelit |

PASQYRA E LËNDËS

| | |
|--|----|
| SHKURTIME | 53 |
| 1. HYRJE | 57 |
| 2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET | 59 |
| 3. PLANI I TRAJNIMIT | 60 |
| 4. MODULI 1 - GJKATA E LARTË, NDRYSHIMET QË SOLLI REFORMA NË DREJTËSI..... | 63 |
| 4.1 ÇFARË DUHET TË DIMË PËR GJKATËN E LARTË?..... | 63 |
| 4.2 DISKUTIM NË LIDHJE ME PROBLEMATIKAT AKTUALE TË KUPTIMIT DHE TË ZBATIMIT TË KUADRIT LIGJOR NGA INSTITUCIONET DHE AKTORËT E SISTEMIT | 64 |
| 5. MODULI 2 - KRITERET LIGJORE PËR NGRITJEN NË DETYRË DHE VLERËSIMI I TYRE | 66 |
| 5.1 ÇFARË KUPTOJMË ME “NGRITJE NË DETYRË” NË LIDHJE ME GJKATËN E LARTË? | 66 |
| 5.2 SI VERIFIKOHEN KUSHTET DHE KRITERET LIGJORE PËR NGRITJEN NË DETYRË NË GJKATËN E LARTË..... | 66 |
| 6. MODULI 3 - RENDITJA E KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR PËR NGRITJEN NË DETYRË 72 | |
| 6.1 HAPAT, KRITERET DHE PËRPARËSITË E RENDITJES SË KANDIDATËVE | 72 |
| 6.1.1 HAPI I PARË, VLERËSIMI ETIK DHE PROFESIONAL SI KRITER DHE PËRPARËSI NË RENDITJEN E KANDIDATËVE | 73 |
| 6.1.2 HAPI I DYTË, PËRVOJA SPECIFIKE SI KRITER DHE PËRPARËSI NË RENDITJEN E KANDIDATËVE | 74 |
| 6.1.3 HAPI I TRETË, VJETËRSIA SI GJYQTAR SI PËRPARËSI NË RENDITJEN E KANDIDATËVE | 74 |
| 6.2 MONITORIMI I KRITEREVE TË VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE DHE METODOLOGJIA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE | 75 |
| 7. MODULI 4 - PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË DHE GARANCITË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KANDIDATIT | 76 |
| 7.1 PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË DHE MËNYRA E MBLEDHJES SË TË DHËNAVE PËRKATËSE | 76 |
| 7.1.1 FAZAT E PROCEDURËS SË PËRZGJEDHJES PËR NGRITJEN NË DETYRË..... | 76 |
| 7.1.2 VENDIMI PËR RENDITJEN E KANDIDATËVE DHE VENDIMI PARAPRAK I PROPOZIMIT PËR EMËRIM. E DREJTA E ANKIMIT | 78 |
| 7.1.3 VENDIMI PËR NGRITJEN NË DETYRË | 79 |
| 7.1.4 VENDIMI PËRFUNDIMTAR I PROPOZIMIT PËR EMËRIM NË GJKATËN E LARTË | 79 |

| | |
|--|----|
| 7.2 MONITORIMI I PROCEDURAVE TË NGRITJES NË DETYRË DHE USHTRIMIT NGA ANA E TYRE I TË DREJTAVE PROCEDURALE | 79 |
| 8. PYETJE DHE ÇËSHTJE PËR DISKUTIM..... | 81 |
| 9. EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI..... | 83 |
| 10. BIBLIOGRAFIA..... | 97 |

1. HYRJE

Manuali i Trajnimit mbi “**Ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë**” vjen si një vijimësi e Guidës Monitorimi për Shoqërinë Civile “Aksesi në Drejtësi dhe Gjykimi i Drejtë”, synimi i të cilës është aftësimi i organizatave të shoqërisë civile, si aktorë aktivë të shoqërisë, që ndërmarrin nisma në kuadër të rritjes së pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies efektive, përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të pavarura të drejtësisë me qëllim zbatimin me korrektësi të legjislacionit në fuqi nëpërmjet:

- Zhvillimit të një kornize të përgjithshme njohjeje të veprimtarisë së organeve të pavarura të drejtësisë, funksioneve, kompetencave dhe kufizimeve të tyre për sa i përket çështjes së zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve përmes mekanizmit të ngritjes në detyrë.
- Ofrimit për organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve të një kornize të përbashkët referimi, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizojnë nismat e tyre për të monitoruar me promovimin e gjyqtarëve brenda sistemit gjyqësor bazuar në kritere objektive, aftësitë profesionale dhe në meritë.

Në vijim të treguesve dhe faktorëve të përcaktuara në Guidë, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe standardet që duhet të zbatohen për zhvillimin e një procesi të rregullt ngritje në detyrë, duke u ndalur në tre komponentët kryesorë që parashikon edhe rregullimi ligjor mbi ngritjen në detyrë në sistemin gjyqësor në përgjithësi dhe për herë të parë edhe për Gjykatën e Lartë, e cila qëndron edhe në majën e piramidës së këtij sistemi, e cila si një gjykatë ligji siguron dhe vendos standardet e një gjykimi të drejtë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin. Këto komponentë lidhen me **kriteret ligjore, kriteret e renditjes së kandidatëve dhe procedurat përkatëse për ngritjen në detyrë**. Analiza e kuadrit të brendshëm ligjor do të ndërthuret me praktikën e deritanishme të Këshillit të Lartë Gjyqësor, si dhe do të prezantohen disa vendime të praktikës së tij me qëllim dhënien e një tabloje të plotë të mënyrës së zbatimit dhe respektimit të këtyre parimeve dhe ofrimit të elementeve të referimit për monitorimin e këtyre elementëve nga aktorët e drejtësisë.

Manuali do të ndahet në 4 module, ku secili modul do të strukturohet në disa aspekte, me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë komponentët e mësipërm:

Moduli i parë – do të përmbajë një prezantim mbi ndryshimet që ka sjellë reforma në drejtësi si në arkitekturën e institucioneve të drejtësisë duke vendosur për herë të parë Gjykatën e Lartë brenda piramidës së sistemit gjyqësor, si dhe duke i dhënë gjithashtu rol

primar Këshillit të Lartë Gjyqësor në përzgjedhjen dhe propozimin për emërim të anëtarëve (nga radhët e gjyqësorit) të Gjykatës së Lartë. Duke qenë se këto ndryshime në kuadrin ligjor dhe kushtetues ishin një risi për sistemin e vetëqeverisjes gjyqësore, ato kërkonin edhe ndërtimin e një baze nënligjore dhe rregullatore, të cilat u shoqëruan edhe me problematika dhe vështirësi. Për këtë arsye është e rëndësishme që zhvillimet rregullatore dhe procedurale që lidhen me promovimin në Gjykatën e Lartë të shihen së bashku me proceset e tjera të rregullimit të karrierës brenda sistemit gjyqësor.

Moduli i dytë - do të përmbajë një analizë të detajuar të kuadrit ligjor dhe atij nënligjor në fuqi mbi zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, një prezantim të përkufizimit se çfarë kuptojmë me ngritje në detyrë, ku përfshihet edhe koncepti i promovimit dhe emërimi në funksion si gjyqtar i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, në këtë modul do të trajtohen kriteret e ndryshme që kandidatët duhet të plotësojnë – kontrolli i pasurisë dhe i figurës, përvoja profesionale dhe vlerësimet etike – profesionale – si parakusht për ngritjen në detyrë.

Moduli i tretë - do të përmbajë informacion të detajuar mbi hapat e përdorur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor për përcaktimin dhe renditjen e kandidatëve gjyqtarë, me qëllim ngritjen në detyrë të kandidatit që plotëson më shumë kushtet dhe kriteret e përcaktuara në ligj dhe në vendimet e KLGj-së të nxjerra për zbatim të tij.

Moduli i katërt – do të përmbajë informacion mbi procedurat e ndjekura nga institucioni duke filluar nga caktimi i relatorit, veprimet përkatëse të kryera prej tij, mjetet dhe garancitë ligjore të kandidatëve për respektimin e të drejtave të tyre, si dhe procedurave të ndjekura nga Komisioni vlerësues përkatës (KZHK) deri në shqyrtimin e çështjes në KLGj.

2. OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET

Ky manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, të studentëve, të gazetarëve, të praktikantëve të ligjit dhe thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet në të cilat bazohet promovimi i gjyqtarëve në RSh, me fokus zhvillimin e procedurave për ngritjen në detyrë nga KLGj-ja, si dhe kriteret ligjore të përdorura për renditjen e tyre deri në propozimin për emërim ose emërim të tyre.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi standardet dhe kuadrin e brendshëm ligjor dhe nënligjor në lidhje me sistemin e zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, si dhe rëndësisë së një sistemi të mirëpërcaktuar të ngritjes në detyrë të magistratëve në Gjykatën e Lartë;
- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi institucionet përgjegjëse (Këshillin e Lartë Gjyqësor, komisioneve përkatëse si të zhvillimit të karrierës, por edhe të vlerësimit të performancës së gjyqtarëve) – veprimtarinë e tyre, si në zbatimin e kriterëve të përcaktuara ligjore dhe në respektimin e procedurave dhe afateve procedurale dhe ndikimin që kanë në pavarësinë, paanësinë dhe llogaridhënien e sistemit gjyqësor;
- Nëpërmjet gërshetimit të metodës teorike dhe rasteve praktike, do të synojmë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit ligjor të aktorëve të shoqërisë civile, të studentëve, të gazetarëve, të praktikantëve të ligjit për zbatimin dhe monitorimin e sistemit të ngritjes në detyrë të gjyqtarëve, me qëllim rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve të pavarura të drejtësisë (KLGj).

Në përfundim të këtij manuali aktorët e shoqërisë civile do të kenë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma, në kuadër të rritjes së pavarësisë, paanësisë, llogaridhënies efektive, përgjegjshmërisë së sistemit gjyqësor dhe institucioneve të pavarura të drejtësisë, me qëllim monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore për sa i përket zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, duke analizuar zbatimin praktik të kriterëve dhe procedurave të ngritjes në detyrë nga institucioni përgjegjës (KLGj) dhe kjo për nivele dhe gjykata të ndryshme (p.sh. Gjykatën e Lartë).

3. PLANI I TRAJNIMIT

Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje gjysmë dite trajnimi (2 orë), sipas tabelës së mëposhtme:

| Aktiviteti | Metoda | Kohëzgjatja |
|--|---|------------------|
| <p>Këndvështrim historik (Moduli 1)</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen në vija të përgjithshme me synimet e reformës në drejtësi dhe sistemin e ri të zhvillimit të karrierës së gjyqtarëve, rolit të KLGj-së në procesin e ngritjes në detyrë të kandidatëve nga radhët e gjyqësorit dhe problematikat në zbatimin e kuadrit ligjor në fuqi.</p> <p>Gjithashtu moduli do të fokusohet në risinë e sjelljes së Gjykatës së Lartë jo vetëm si pjesë e sistemit të gjykatave në RSh, por edhe si pjesë e të gjitha proceseve të vlerësimit, të karrierës dhe të disiplinës në sistemin gjyqësor. Për këtë arsye, është rëndësishme të evidentohen jo vetëm këto ndryshime, por edhe të realizohet në bashkëpunim me pjesëmarrësit një bazë fillestare të dhënash në lidhje me situatën e GjL-së (deri në plotësimin e trupës gjyqësore sipas kërkesave të ligjit).</p> | <p>Prezantim me PowerPoint – risitë e reformës në drejtësi për Gjykatën e Lartë</p> <p>Diskutim në lidhje me promovimin në GjL nga brenda sistemit të drejtësisë.</p> | <p>30 minuta</p> |

| | | |
|---|---|------------------|
| <p>Kriteret ligjore për ngritjen në detyrë dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse (Moduli 2)</p> <p>Me anë këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me përkufizimin e ngritjes në detyrë sipas legjislacionit shqiptar. Njohjen e legjislacionit parësor dhe atë dytësor që parashikon parime dhe rregulla mbi zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve, si dhe kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta për kandidatët gjyqtarë që synojnë ngritjen në detyrë në GjL.</p> | <p>Prezantim me PowerPoint</p> <p>Diskutim në grupe të vogla për konceptet e hartuara nga legjislatori në secilin nga kriteret ligjore dhe zbatimin e tyre praktik (përvoja, pasuria, figura, vlerësimi, rivlerësimi).</p> <p>Hartimi i treguesve për secilin nga konceptet sa më sipër dhe vlerësimi i tyre në kazuse të veçanta (ku plotësimi i çdonjërit nga treguesit vlerësohet me 1 (.05-pjesërisht dhe 0 - fare)</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/rasteve praktike</p> | <p>30 minuta</p> |
| <p>Kriteret e renditjes së kandidatëve dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse (Moduli 3)</p> <p>Me anë këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen me tre hapat dhe kriteret e përdorura nga Këshilli, të cilat i shërbejnë Këshillit për renditjen e kandidatëve gjyqtarë për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë.</p> | <p>Prezantim me PowerPoint</p> <p>Plotësimi i skedave të monitorimit dhe plotësimi i tyre në dy grupe: grupi 1 – vlerësimi i procedurave të emërimit (moduli 3) dhe 2 – respektimi i të drejtave procedurale. (Moduli 4)</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve praktike</p> | <p>30 minuta</p> |

| | | |
|---|--|------------------|
| <p>Procedurat e ngritjes në detyrë dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse (Moduli 4)</p> <p>Me anë të këtij moduli, pjesëmarrësit do të njihen dhe thellojnë njohuritë në lidhje me procedurat e ngritjes në detyrë për gjyqtarët në Gjykatën e Lartë dhe procedurat e ndjekura duke filluar nga veprimet e kryera nga relatori/rja, më pas nga Komisioni dhe deri në Këshill.</p> <p>Gjithashtu pjesëmarrësit do të njihen dhe me të drejtën për ankim të kandidatëve, me qëllim respektimin e të drejtave të tyre dhe vendimin e Këshillit për emërim.</p> | <p>Prezantim i gjetjeve nga puna në grup</p> <p>Përmbledhje e indikatorëve me PowerPoint</p> <p>Vlerësimi i indikatorëve (detyrë në vazhdimësi të trajnimit)</p> <p>Një listë me 10-15 tregues do të përzgjidhen dhe secili nga pjesëmarrësit do të marrë si detyrë vlerësimin e tij me një grup interesi (gjyqësori, avokatia, shoqëria civile dhe media)</p> | <p>30 minuta</p> |
|---|--|------------------|

4. MODULI 1

GJYKATA E LARTË, NDRYSHIMET QË SOLLI REFORMA NË DREJTËSI

4.1 Çfarë duhet të dimë për Gjykatën e Lartë?

Gjykata e Lartë e Republikës së Shqipërisë² qëndron në majën e piramidës gjyqësore. Ajo siguron dhënien e barabartë dhe të paanshme të drejtësisë për të gjithë qytetarët në vend dhe vendos standardet e një gjykimi të drejtë. Gjykata e Lartë e ushtron pushtetin në përputhje me parashikimet Kushtetuese dhe ligjin. Parimet themelore që e udhëheqin Gjykatën e Lartë në veprimtarinë e saj gjyqësore janë: pavarësia, paanësia, efikasiteti, barazia, drejtësia, besueshmëria, llogaridhënia dhe aksesit transparent në drejtësi për të gjithë.

Si gjykata më e lartë në vend, Gjykata e Lartë mbulon të gjithë territorin e vendit. Selia e saj është në Tiranë. Ajo shqyrton rekursat kundër vendimeve të gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatat e posaçme të shkallëve më të ulëta, me misionin e vetëm që të sigurojë unifikim dhe zhvillim të mëtejshëm të praktikës gjyqësore. Gjykata e Lartë i ushtron funksionet gjyqësore përmes kolegjeve të saj në fushën administrative, civile dhe penale. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore sipas ligjit.

Pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore në kuadër të reformës në drejtësi të vitit 2016, gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë, sipas ligjit. Pjesa më e madhe e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve, të cilët duhet të kenë të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.

Gjykata e Lartë e kryen veprimtarinë e saj gjyqësore mbi bazën e këtyre akteve³:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë

Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurës Civile

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë

Kodi i Procedurës Penale

2. http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Zgjedhja_dhe_statusi_i_gjyqtareve_9901_1.php

3. http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Baza_ligjore_9900_1.php

Ligji për Organizimin dhe funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative

Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë

Ligji për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë

Ligji për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Ligji për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë

Ligji për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar

Kodi i Etikës Gjyqësore

Ligji për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë

Ligj Nr.115/2016 “ Për organet e qeverisjes se sistemit të drejtësisë”

Ligj Nr.84/2016 “Per rivleresimin kalimtar te gjyqtareve dhe prokuroreve ne Republiken e Shqiperise”

4.2 Diskutim në lidhje me problematikat aktuale të kuptimit dhe të zbatimit të kuadrit ligjor nga institucionet dhe aktorët e sistemit

Ndonëse paketa e reformës në drejtësi u miratua në vitin 2016 dhe procesi i rivlerësimit kalimtar solli largimin me shkarkim, dorëheqje apo mbarim të mandatit të një pjese të konsiderueshme gjyqtarësh, institucionet e reja që qeverisjes së gjyqësorit u ngritën vetëm në fund të vitit 2019. Gjatë vitit 2019 dhe 2020, KLGj-ja miratoi një sërë aktesh që bënë të mundur nga njëra anë ngritjen në detyrë të gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë dhe nga ana tjetër vlerësimin etik dhe profesional të gjyqtarëve, i cili është një nga parakushtet e promovimit të tyre. Plotësimi i bazës ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë bëri të mundur që gjyqtarët e parë nga radhët e gjyqësorit u emëruan vetëm në mars 2021. Në shtator 2023, Gjykata e Lartë ka 18 gjyqtarë, 14 prej tyre nga radhët e magistratëve.

Treguesit e realizimit

Disa nga treguesit për monitorim në lidhje me zbatimin e kuadrit të posaçëm ligjor në lidhje me GjL-në, mund të hartohen përmes pyetjeve të mëposhtme:

1. A ka gjykata numrin e gjyqtarëve të përcaktuar në ligj? PO/ JO
2. Si është aktualisht përbërja e gjykatës? X / 19
3. Sa kandidatë aplikuan mesatarisht për një pozicion të lirë? X kandidatë për pozicion

Burime të mbledhjes së të dhënave:

- Kërkesa me shkrim KLGj-së apo institucioneve të përfshira në procesin e promovimit (p.sh. organeve të vetingut, Ministrisë së Drejtësisë, etj).
- Faqet e GjL-së dhe KLGj-së
- Raportet vjetore të KLGj-së sipas viteve
- Monitorim i analizës vjetore të GjL-së
- Monitorim i raportimit të KLGj-së në kuvend

- Monitorim në lidhje me problematikat e funksionimit të GjL-së në media
- Raporti i Progresit të BE-së (vjetor)

Mbi bazën e të dhënave të grumbulluara nga disa burime sa më sipër për qëllime të monitorimit të problematikave apo edhe zhvillimeve në lidhje me promovimin e magjistratëve në Gjykatën e Lartë, është e rëndësishme të hartohen përmbledhje e matjeve / vlerësimeve të një grupi specifik treguesish që janë të rëndësishëm për gjurmimin e rezultateve të ndërhyrjeve të veçanta si reformave në rastin në fjalë. Këto vlerësime fillestare bëhen zakonisht përpara apo në fazat e para të fillimit të një ndërhyrjeje apo programi monitorimi dhe vlerësimi. Është e udhës që treguesit të cilët zhvillohen gjatë vlerësimit fillestar apo baseline të jetë të njëjtë me ato që vlerëson përgjatë programit apo në faza të caktuara të tij. Treguesit mund të jenë sasiorë, cilësorë dhe mik. Ato hartohen duke iu përgjigjur pyetjeve të cilave kërkuesve ju lindin gjatë njohjes me kuadrin ligjor, përvojave të veçanta që lidhen me gjykatën, kërkesa apo ankesa të subjekteve të interesuara për proceset promovuese, raportimet e medias apo vetë institucioneve përgjegjëse p.sh. raportimit vjetor të KLGj-së në kuvend.

5. MODULI 2

KRITERET LIGJORE PËR NGRITJEN NË DETYRË DHE VLERËSIMI I TYRE

5.1 Çfarë kuptojmë me “ngritje në detyrë” në lidhje me Gjykatën e Lartë?

Sipas nenit 47 të ligjit nr. 96/2016 “Ngritje në detyrë” nënkupton kalimin nga një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë. Të promovohesh në Gjykatën e Lartë është një nga pozicionet më të rëndësishme dhe arritjet fundore në karrierën e një gjyqtari. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse, pra civile, administrative apo penale të kërkuara për pozicionin e lirë. Në tërësinë e përvojave profesionale të përgjithshme dhe atyre specifike përfshihet edhe përvoja si magjistrat i komanduar.

Rregullat e vendosura nga KLGj-ja në vendimin nr. 70/ 2020, mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve (shih manuali nr. 2) zbatohen ndaj të gjithë gjyqtarëve që përmbushin kriteret ligjore. Këto rregulla janë të aplikueshme si për gjyqtarët që duan të promovohen në GjL ashtu edhe ata në gjykatat e apelit apo GjKKO.

5.2 Si verifikohen kushtet dhe kriteret ligjore për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë

Verifikimi i kushteve dhe i kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë në Gjykatën e Lartë, rregullohet me vendimin nr. 75/2019 (*azhornuar me Vendimin nr. 528, datë 10.11.2021*) të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Sipas nenit 4 pika 2 e këtij vendimi, “procedura e verifikimit” është procesi administrativ i verifikimit të kushteve ligjore për emërimin, riemërimin, ngritjen në detyrë, si dhe i verifikimit të pasurisë dhe i figurës së kandidatëve. Procedura e verifikimit të kandidatëve fillon me vendim të Këshillit, jo më vonë se 7 ditë nga përfundimi i afatit të kandidimit të gjyqtarëve për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë. Në të njëjtën ditë me fillimin e procedurës së verifikimit zhvillohet edhe procedura e shortit për caktimin, ndërmjet anëtarëve të Komisionit, të relatorit për secilin kandidat.

Relatori i çështjes kujdeset për zhvillimin e procedimit individual të verifikimit dhe sidomos për sa më poshtë: a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga kandidati; b) përgatitjen e projekt-aktit administrativ; c) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit; ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit; d) njoftimet për kandidatin.

Komente sugjerime në lidhje me hapat e monitorimit:

| | | | |
|---|---|---|--|
| Procedura administrative e verifikimit të kandidatëve realizohet në katër faza të njëpasnjëshme | | | |
| a) veprimet procedurale paraprake të relatorit të çështjes; | b) veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes; | | |
| | | c) shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Komisioni; | |
| | | | ç) shqyrtimi dhe miratimi i projekt-aktit të verifikimit nga Këshilli. |

Skedë monitorimi në lidhje me respektimin e të drejtave të kandidatit gjatë procesit të kualifikimit:

| Të drejtat e kandidatit | Komente dhe / ose sugjerime për monitorim në lidhje me respektimin e të drejtave të kandidatit | PO -1 / JO - 0 |
|--|--|-----------------------|
| Njohja me relatorin e çështjes menjëherë me fillimin e procedurës së verifikimit | | |
| E drejta për të kërkuar përjashtimin e relatorit / anëtarit të këshillit nga vendimmarrja në lidhje me procedurën e verifikimit. | Afati 3-ditor për kërkesën Monitorim i vendimmarrjes së këshillit në lidhje me përjashtimin e relatorit / anëtarit | |
| E drejta që, në çdo fazë të procedurës së verifikimit të njihet me dokumentet e dosjes, aktet procedurale të kryera nga relatori dhe Këshilli për verifikimin e kandidaturës, si edhe të marrë kopje të tyre, sipas rregullave të Kodit të Procedurave Administrative dhe atyre të përcaktuara në këtë vendim. | Verifikim i kërkesave për njohjen me dokumentet dhe aktet e kryera. | |

| | | |
|--|--|--|
| E drejta të paraqesë shpjegime me shkrim për faktet, rrethanat apo çështjet ligjore të lidhura me kandidimin e tij/saj, si dhe të depozitohet dokumente shkresore shtesë, në mbështetje të këtyre shpjegimeve. | Monitorim i afatit 5-ditor nga njoftimi për gjetjet e relatorit dhe dhënien e shpjegimeve. | |
| Kandidati ka të drejtë të tërhiqet në çdo kohë nga kandidimi, duke e njoftuar me shkrim Këshillin. | Monitorim i vendimmarrjes së këshillit për tërheqjen e kandidatit. | |

Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit të çështjes

Procedura e verifikimit të kandidatëve fillon dhe zhvillohet njëkohësisht për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit. Relatori i çështjes ndjek dhe kryen të gjitha veprimet procedurale dhe verifikuese të lidhura me proceset e ndryshme të verifikimit të përmbushjes së kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore nga kandidati. Krahas veprimeve procedurale dhe verifikuese të tjera që i vlerëson të nevojshme. Nëse nga shqyrtimi i dokumentacionit të paraqitur nga kandidati, relatori i çështjes konstaton dhe vlerëson se është i paplotë, njofton menjëherë kandidatin për të përmbushur detyrimin e plotësimit të tij sipas ligjit, duke i caktuar një afat jo më shumë se 5 ditë për dorëzimin e tij pranë zyrës përkatëse të Këshillit. Në procedurën e verifikimit, relatori i çështjes shqyrton dokumentacionin e paraqitur nga kandidati, formularët e deklarimeve të plotësuar, aktet e dërguara nga organet e ngarkuara me ligj për kontrollin dhe verifikimin e deklarimeve të kandidatit, si edhe çdo akt, informacion dhe të dhënë tjetër të dërguar nga subjektet publike dhe private, me nismën e tyre ose mbi kërkesën e Këshillit apo që relatori i çështjes vlerëson se ka lidhje me gjykimin mbi plotësimin ose jo të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore për kandidim.

Bazuar në gjetjet e procedurës së verifikimit, nëse vlerëson paraprakisht që mund të procedohet me urdhërimin e kualifikimit ose të skualifikimit të kandidatit, pasi vë në dijeni Komisionin, me vendim të këtij të fundit, relatori i çështjes njofton kandidatin e verifikuar lidhur me gjetjet paraprake, si edhe për të drejtën që: a) brenda një afati 5-ditor nga dita e njoftimit, të paraqesë me shkrim, drejtpërdrejt pranë zyrës përkatëse të Këshillit ose në rrugë elektronike, qëndrimin dhe shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e procedurës së verifikimit, si edhe të dokumentacionit mbështetës të nevojshëm sipas vlerësimit të kandidatit; b) të tërheqë, sipas rastit, kopje të dokumentacionit dhe të akteve të këtij procedimi administrativ ose të asaj pjesë të tyre që lidhet me verifikimin e kushteve dhe kriterëve përkatëse ligjore, për të cilat relatori ka vlerësuar paraprakisht se mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

- Nëse në përfundim të këtyre procedurave administrative për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori i çështjes vlerëson se nuk ka të dhëna që mund të sjellin skualifikimin e kandidatit, procedon me përgatitjen e çështjes dhe të relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm

dhe e dërgon menjëherë çështjen për shqyrtim përpara Komisionit. Komisioni, nëse verifikimet janë të plota, vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

- Nëse vlerëson që kandidati nuk përmbush ndonjërin prej kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, relatori i çështjes procedon me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe dërgimin menjëherë të çështjes për shqyrtim përpara Komisionit, pa qenë e nevojshme kryerja e procedurës së verifikimit për të gjitha kushtet dhe kriteret e tjera ligjore. Komisioni vendos për dërgimin e çështjes në mbledhjen e Këshillit.

Skedë monitorimi në lidhje me dërgimin dhe plotësimin e formularëve të verifikimit të kandidatit:

| | Dërguar kandidatit brenda afatit të përcaktuar në vendimin 75/2029 | Plotësuar, nënshkruar, dorëzuar sipas përcaktimeve të rregullores për verifikimin e kandidatit |
|--|--|--|
| “Deklaratë e pasurisë dhe interesave private e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” | Po/Jo | |
| Formularin e “Vetëdeklarimit” sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” | Po/Jo | |
| Formular aplikimi “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”, në përputhje me parashikimet ligjore të nenit 29 të Ligjit nr. 45/2015 (për kandidatët e vitlindjes më të hershëm se korrik 1977) | Po/Jo | |
| Formularin për dhënien e miratimit për përpunimin e të dhënave personale | Po/Jo | Nënshkruar fizikisht |
| Formularin autorizues për verifikimin, në të gjitha subjektet publike dhe private, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, të të dhënave që lidhen me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit | Po / Jo | Nënshkruar fizikisht |
| Formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturës | Po/Jo | Nënshkruar fizikisht |

Këshilli vendos skualifikimin e kandidatit nëse ai nuk përmbush qoftë edhe njërin nga kushtet ose kriteret e tjera ligjore të kandidimit, si dhe në rastet e mosplotësimit ose refuzimit të plotësimit të formularëve që kanë të bëjnë me kontrollin e pasurisë, integritetin, figurën, veprimtarinë të cilat nuk përputhen me statusin (sipas ndalimeve të parashikuara në nenet 6 dhe 28 të ligjit për statusin), shkeljeve të disiplinës etj.

| Kriteret ligjore | Deklarimi i pasurisë | Verifikimi i figurës dhe integritetit të kandidatit | Verifikimi i kushteve të tjera ligjore të kandidimit |
|---|--|---|---|
| a) deklarinimet dhe dokumentacionin e paraqitur nga vetë kandidati; | a) burimet financiare të kandidatit nuk justifikojnë pasuritë e tij; b) kandidati nuk ka deklaruar pasuri, asete ose të dhëna mbi interesat private, që janë të detyrueshme të deklarohen; c) kandidati ka dhënë një deklaratë të rreme ose jo të saktë të aseteve; ç) kandidati gjendet në situatën e konfliktit të interesit. | a) ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar b) ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991. c) ka qenë ose është bashkëpunëtor, informator ose agjent i shërbimeve të inteligjencës. | <u>Sipas nenit 6 të ligjit për statusin:</u> a) anëtarësim në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike; b) kryerjen e çdo veprimtarie politike që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar. |
| b) gjetjet dhe përfundimet e organeve kompetente të kontrollit të pasurisë dhe të integritetit të kandidatit, si edhe informacionet e subjekteve të tjera publike dhe private dërguar në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit. | | | Neni 28 i ligjit për statusin: dh) është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe / ose ka masë disiplinore në fuqi; |

| | | | |
|---|--|---|--|
| <p>c. kandidati përsëri nuk i përmbush detyrimet për paraqitjen ose plotësimin e deklaratave, autorizimeve dhe të dokumentacionit lidhur me kushtet dhe kriteret e tjera ligjore të kandidimit të parashikuara nga ligji.</p> | <p>a) nuk ka plotësuar ose depozituar pranë ILDKPKI-së, formularin e deklaratës së pasurisë;</p> <p>b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.</p> | <p>a) nuk ka plotësuar ose depozituar formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr. 138/2015 dhe/ose formularin e aplikimit “Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta” sipas Ligjit nr. 45/2015;</p> <p>b) ka refuzuar ose nuk ka depozituar, të nënshkruar, autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij.</p> | |
|---|--|---|--|

6. MODULI 3

RENDITJA E KANDIDATËVE TË KUALIFIKUAR PËR NGRITJEN NË DETYRË

6.1 Hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

Pas verifikimit të kushteve të pranueshmërisë që u diskutuan në modulën e dytë, për plotësimin e vendeve në gjykatën e posaçme të shkallës së parë, përmes procedurës së ngritjes në detyrë, KLGj-ja zbaton kriteret e parashikuara nga neni 48/9 të Ligjit Për Statusin e Gjyqtarëve dhe Prokurorëve.

Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe renditin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme:

- a) *së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh:*
 - i) *që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tri vite përpara kandidimit do të ketë përparësi;*
 - ii) *në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor;*
- b) *së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës "a", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë;*
- c) *së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës "b", të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.*

Procesi i renditjes së kandidatëve është edhe më i rëndësishmi pasi përtej kushteve ligjore, ky proces vlerëson meritat e secilit kandidat duke siguruar edhe emërimin e kandidatit më të mirë. Siç e parashikon edhe ligji, shqyrtimi dhe renditja e kandidaturave kryhet në 3 (tri) faza ose hapa ku për secilën prej tyre janë përcaktuar edhe kriteret e përparësisë (shih neni 9 më sipër). Faza pasuese e renditjes ndiqet vetëm nëse në përfundim të fazës paraardhëse nuk arrihet të bëhet renditja e kandidatëve me rezultate të njëjta më të larta. Në lidhje me zbatimin e këtyre kriterëve dhe procedurave për ngritjen në detyrë, përfshirë këtu edhe GjL-në, KLGj-ja ka hartuar vendimin nr. 70, datë 07.02.2020, për zbatim ndër të tjera të pikës 9, të Ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë".

6.1.1 Hapi i parë, vlerësimi etik dhe profesional si kriter dhe përparësi në renditjen e kandidatëve

Në fazën e parë, renditja e kandidatëve bazohet në vlerësimin krahasues të niveleve të dy vlerësimeve të mëparshme etike dhe profesionale. Kandidati me nivelet më të larta të vlerësimit etik dhe profesional, renditet më lart. Pra, si shembull, nëse për një vend vakant ka dy kandidatë, nga të cilët njëri ka dy vlerësimet e mëparshme shkëlqyeshëm dhe tjetri ka dy vlerësimet e mëparshme njërin shkëlqyeshëm dhe tjetrin shumë mirë, përzgjidhet kandidati me dy vlerësimet e mëparshme shkëlqyeshëm.

Në rast se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta (si shembull, nëse për një vend vakant, kandidati 1 ka vlerësimin e parafundit shumë mirë dhe vlerësimin e fundit shkëlqyeshëm, ndërkohë që kandidati 2, ka vlerësimin e parafundit shkëlqyeshëm dhe vlerësimin e fundit shumë mirë), për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta zbatohen përparësitë sipas radhës së mëposhtme:

- a) “niveli i vlerësimit të fundit” – sipas kësaj përparësie, kandidati me nivelin më të lartë të vlerësimit të fundit etik dhe profesional, renditet më lart;
- b) “përvoja si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” – sipas kësaj përparësie, kandidati që ka një nga këto përvoja, renditet më lart (për ta ilustruar me shembull, në këtë rast të dy kandidatët do të kishin vlerësimet e fundit shkëlqyeshëm dhe vlerësimin e parafundit shumë mirë, por kandidati 1, ka përvojë si gjyqtar i komanduar; në këtë rast përzgjidhet kandidati 1).
- c) “kohëzgjatja e përvojës si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit” – sipas kësaj përparësie, kandidati me përvojën me kohëzgjatjen më të madhe në vite, renditet më lart (në këtë rast, të dy kandidatët do të kishin përvojë si gjyqtarë të komanduar, por kandidati 1 ka shërbyer si gjyqtar i komanduar për 5 vite, ndërkohë që kandidati 2, ka shërbyer si gjyqtar i komanduar për 3 vite; në këtë rast do të përzgjidhet kandidati 1);
- ç) “shumëllojshmëria e përvojave si gjyqtar i komanduar, si gjyqtar në skemën e delegimit ose si anëtar i Këshillit” – sipas kësaj përparësie, kandidati që ka më shumë nga këto përvoja, renditet më lart (në këtë rast, të dy kandidatët kanë kohëzgjatje të njëjtë si gjyqtarë të komanduar, por kandidati 1 ka përvojë edhe si anëtar i Këshillit; në këtë rast do të përzgjidhet kandidati 1);

Vlen për t’u sqaruar se “Përvojë në pozicionet e komanduara”, nënkupton përvojën e veçantë të punës së kandidatit si gjyqtar i komanduar: në pozicionin e ndihmësmagjistratit në Gjykatën e Lartë, në Gjykatën Kushtetuese; në pozicionin e inspektorit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; në pozicione të tjera në Këshillin e Lartë Gjyqësor, në Ministrinë e Drejtësisë, në Avokaturën e Shtetit, në Shkollën e Magjistraturës ose në çdo institucion tjetër brenda sistemit të drejtësisë dhe përafrimit të legjislacionit, sipas pikës 2, të nenit 53, të Ligjit për Statusin; në çdo pozicion tjetër të ndryshëm nga këto, kur komandimi është bërë

për interes publik, sipas pikës 7, të nenit 54, të Ligjit për Statusin; si dhe në çdo pozicion ku është komanduar me vendim të institucioneve të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi përpara Ligjit për Statusin, në rastin kur gjyqtari ka kryer të gjithë periudhën e komandimit;

Në rast se edhe pas zbatimit të përparësive si më sipër, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në skemën e pikëve të miratuar nga Këshilli me:

- a) vendimin nr. 263, datë 21.11.2019, “Për rregullat plotësuese të vlerësimit të gjyqtarëve” dhe vendimin nr. 264, datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”; ose
- b) vendimin nr. 102, datë 5.7.2019, “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo-gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë” dhe vendimin nr. 209, datë 11.10.2019, “Metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo-gjyqtarë për në Gjykatën e Lartë”.

6.1.2 Hapi i dytë, përvoja specifike si kriter dhe përparësi në renditjen e kandidatëve

Duke iu referuar udhëzimit nr. 70/2020 të KLGj-së, për ngritjen në detyrë të gjyqtarëve, në rast se pas vlerësimit të bërë si më sipër, ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në përvojën profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë. Kandidati që ka përvojë profesionale specifike, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi kohëzgjatja e përvojës profesionale specifike. Kandidati me përvojën profesionale specifike me kohëzgjatjen më të madhe, renditet më lart.

6.1.3 Hapi i tretë, vjetërsia si gjyqtar si përparësi në renditjen e kandidatëve

Në rast se pas vlerësimit të bërë sipas kriterëve të mësipërme rezulton se ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si gjyqtar. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, për renditjen e kandidatëve me rezultatet më të larta merr përparësi zhvillimi i karrierës si gjyqtar. Kandidati me karrierë më të zhvilluar, renditet më lart.

Në rast se edhe pas kësaj ka më shumë se një kandidat me rezultate të njëjta, renditja e kandidatëve me rezultatet më të larta bazohet në vjetërsinë si jurist. Kandidati me vjetërsinë më të madhe, renditet më lart. “Vjetërsi si jurist”, nënkupton përvojën e përgjithshme të punës së kandidatit si jurist në institucione publike, subjekte shtetërorë ose private.

6.2 Monitorimi i kriterëve të vlerësimit të kandidatëve dhe metodologjia e mbledhjes së të dhënave

Në lidhje me monitorimin e kriterëve për renditjen e kandidatit për GjL, mund të përdoret apo të adaptohet një skedë e ngjashme si në tabelën e mëposhtme:

| <i>Kandidati</i> | <i>Rezultati i vlerësimit të fundit profesional të kandidatit</i> | <i>Rezultati i vlerësimit të parafundit profesional të kandidatit</i> | <i>Përvoja në pozicionet e komanduar</i> | <i>Kohëzgjatja e periudhës së komandimit në vite (n.q.s. ka)</i> | <i>Magjistrati ka përvojë në skemën e delegimit</i> | <i>Magjistrati ka përvojë si anëtar i KLGJ-së (përgjashtuar 3 vitet e fundit)</i> |
|------------------|---|---|--|--|---|---|
| <i>Pikët</i> | <i>Shkëlqyeshëm; Shumë mirë</i> | <i>Shkëlqyeshëm; Shumë mirë</i> | <i>PO / JO</i> | <i><1 1-3 4-6 7-10</i> | <i>PO / JO</i> | <i>PO / JO</i> |

Në lidhje me monitorimin e proceseve të renditjes së kandidatëve është e rëndësishme të kuptohet radha e përparësisë së kriterëve, ku së pari renditet vlerësimi etik dhe profesional. Vetëm kur ky kriter nuk prodhon një kandidat fitues, kalohet në kriterin tjetër që është përvoja profesionale e kështu me radhë, në hapin e dytë dhe të tretë të renditjes.

Megjithëse nga pikëpamja formale monitorimi i kriterëve të renditjes është pjesa më e rëndësishme sepse përcakton edhe kandidatin e renditur më lart, nga perspektiva e interesit të publikut ka disa tregues të tjerë të cilët duhet të merren parasysh. Ndër të tjera mund të përmendim:

- Zbatimi i rregullave për konfliktin e interesit dhe përjashtimin e personit nga procesi i vendimmarrjes sipas ligjit “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.
- Kohëzgjatja dhe prioritizimi i vlerësimeve etike dhe profesionale si të magjistratëve ashtu edhe gjyqtarëve të komanduar kur ky vlerësim mungon ose nuk është bërë asnjëherë.
- Respektimi i rregullave të përcaktuara në Kodin e Procedurave Administrative në lidhje me njoftimin mbi të gjitha vendimet e KLGj-së apo komisionit përkatës në lidhje me procesin e renditjes, si dhe të drejtën e ankimit kundër këtyre vendimmarrjeve.

Metodat e përdorura për qëllime monitorimi përfshijnë:

- Informacion zyrtar i kërkuar përmes pyetësorëve nga KLGj-ja;
- Intervista eventuale me gjyqtarët që kandidojnë;
- Vëzhgime dhe intervista me burime të tërthorta si p.sh. specialistë të fushës apo njohës të kuadrit ligjor dhe praktikave të promovimit gjyqësor;
- Shfletimi i raporteve të KLGj-së, raportimeve dhe intervistave të drejtuesve apo anëtarëve si analizave vjetorë të gjykatave mund të plotësohen me studime dhe monitorime të mëparshme apo të ngjashme në tematikë.

7. MODULI 4

PROCEDURAT E NGRITJES NË DETYRË DHE GARANCITË PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË KANDIDATIT

Ky modul do të përmbajë informacion mbi procedurat e ndjekura nga institucioni duke filluar nga caktimi i relatorit, veprimet përkatëse të kryera prej tij, mjetet dhe garancitë ligjore të kandidatëve për respektimin e të drejtave të tyre, si dhe procedurave të ndjekura nga Komisioni vlerësues përkatës (KZhK) deri në shqyrtimin e çështjes në KLGj.

7.1 Procedurat e ngritjes në detyrë dhe mënyra e mbledhjes së të dhënave përkatëse

7.1.1 Fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë

Ngritjes në detyrë kalon në disa faza procedurale duke filluar me caktimin e relatorit, veprimet procedurale verifikuese, shqyrtimi dhe miratimi i tyre nga KZhK dhe Këshilli (KLGj)

A. Fillimi i procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë dhe caktimi i relatorit

Këshilli, jo më vonë se 7 ditë nga vendimi i parë për kualifikimin e një kandidati, vendos fillimin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe cakton, nëpërmjet shortit, relatorin për atë procedurë. Anëtari i Komisionit dhe/ose çdo anëtar tjetër i Këshillit, në çdo kohë kur merr dijeni për ekzistencën e një konflikti interesi ose të një pengese ligjore, është i detyruar të deklarojë natyrën e konfliktit të interesit ose pengesës dhe të heqë dorë nga pjesëmarrja në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

Në rastin e GjL-së, e cila e ka të përcaktuar fushën specifike në të drejtën penale, ka më shumë se një pozicion të lirë, Këshilli kryen vetëm një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë.

B. Veprimet procedurale dhe verifikuese të relatorit

Procedura e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë zhvillohet paralelisht:

- a) me procedurat e verifikimit të kritereve ligjore të kandidimit, të pasurisë dhe të figurës për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë (shih moduli 2);
- b) me procedurat e vlerësimit dhe pikëzimit për kandidatët e tjerë që konkurrojnë për atë pozicion të lirë, të cilët kanë qenë të komanduar në një institucion brenda sistemit

të drejtësisë dhe ky i fundit nuk ka bërë vlerësimin e tyre etik dhe profesional (shih moduli 3)

Vetëm kandidatët e kualifikuar dhe që kanë dy vlerësime etike dhe profesionale bëhen pjesë e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë për atë pozicion të lirë.

Detyrat e relatorit nga pikëpamja procedurale e zhvillimin e procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve për ngritjen në detyrë lidhen me:

- 1) administrimin dhe shqyrtimin e dokumentacionit të kandidatëve, që gjenden në dosjen e tyre personale apo që paraqitet nga ata gjatë procedurës së përzgjedhjes
- 2) përgatitjen e relacionit që përmban përshkrimin e veprimeve të kryera dhe të dokumenteve të administruara gjatë procedurës së përzgjedhjes, si dhe një përmbledhje faktike të tyre për aq sa është e nevojshme për renditjen e kandidatëve, duke i bashkëlidhur atij kopje të këtyre dokumenteve;
- 3) përgatitjen e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim;
- 4) koordinimin me Kryetarin e Komisionit për përgatitjen e mbledhjes së Komisionit;
- 5) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
- 6) njoftimet për kandidatët veçanërisht në rastet kur nevojiten sqarime të mëtejshme ose plotësim i dokumentacionit.

Relatori mund të kërkojë informacion relevant në lidhje me kandidatin si nga subjekte publike ashtu edhe nga ato private, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, sqarime, të dhëna ose kopje të dokumenteve të konfirmuara zyrtarisht prej tyre.

Në përfundim të veprimeve për të gjithë kandidatët në procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në një pozicion të lirë, relatori njofton Kryetarin e Komisionit dhe i paraqet për shqyrtim Komisionit relacionin dhe dokumentacionin e përgatitur për procedurën e përzgjedhjes për ngritjen në detyrë, si dhe projektvendimin për renditjen e kandidatëve.

C. Shqyrtimi dhe miratimi nga KZhK i projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose i projektvendimit paraprak të propozimit për emërim

Kryetari i Komisionit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Komisionit, duke marrë masa për njohjen e anëtarëve me materialet e çështjes. Në mbledhjen e Komisionit, relatori paraqet përmbledhjen e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera, si edhe të fakteve që kanë rezultuar gjatë zhvillimit të procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë të kandidatëve.

Komisioni, pasi dëgjon relatorin, nëse vlerëson që procedura e përzgjedhjes për ngritjen

në detyrë dhe dokumentacioni përkatës i kandidatëve është i paplotë, i kërkon relatorit plotësimin e procedurës apo të dokumentacionit të nevojshëm, duke evidentuar sipas rastit veprimet procedurale dhe/ose dokumentacionin, për të cilët lind nevoja e plotësimit apo saktësimit. Në rast të kundërt, Komisioni vendos për kalimin e çështjes për shqyrtim në Këshill.

D. Shqyrtimi dhe miratimi nga Këshilli

Kryetari i Këshillit, menjëherë pas njoftimit nga relatori për çështjen e përgatitur për shqyrtim, thërret mbledhjen e Këshillit, duke u dërguar anëtarëve edhe materialet e çështjes. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes së Këshillit, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, u njoftohet kandidatëve.

Pas prezantimit të veprimeve procedurale, gjetjeve dhe raportit të relatorit, pyetjeve dhe komenteve nga ana e anëtarëve, Këshilli kalon në fazën e bisedimit dhe vendos për këto çështje, sipas rendit të mëposhtëm:

- a) plotësinë e veprimeve procedurale dhe verifikuese të kryera nga relatori dhe plotësinë e dokumentacionit të nevojshëm për renditjen e kandidatëve. Në rastet kur Këshilli evidenton mangësi në dokumentacion, ai ngarkon relatorin të marrë masa për plotësimin sa më parë të mangësive të evidentuara dhe cakton seancën e radhës, jo më vonë se 7 ditë nga njoftimi i relatorit, ky i fundit paraqet para Këshillit aktet shtesë.
- b) miratimin e projektvendimit të renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim sikundër ai është propozuar nga relatori apo me ndryshime sipas propozimeve të çdo anëtari.

Në përfundim të bisedimeve, Këshilli voton projektvendimin e renditjes së kandidatëve ose të projektvendimit paraprak të propozimit për emërim. Anëtarët votojnë në të njëjtën kohë. Në përfundim të votimit, Kryetari deklaron rezultatin e votimit. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e Kryetarit të Këshillit është përcaktuese.

7.1.2 Vendimi për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim. E drejta e ankimit

Vendimi i Këshillit për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim arsyetohen nga relatori, jo më vonë se 10 ditë nga miratimi, duke reflektuar çdo sugjerim për të cilin kanë rënë dakord shumica e anëtarëve të Këshillit. Vendimi nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Këshillit që kanë marrë pjesë në votim. Vendimi i arsyetuar i Këshillit iu njoftohet kandidatëve.

Kundër vendimit të Këshillit mund të bëhet ankim nga çdo kandidat, në Gjykatën Administrative të Apelit, brenda 5 ditëve, nga dita e njoftimit të vendimit. Gjykata merr vendimin brenda dy javëve nga dita e ankimit. Vendimi i gjykatës është i formës së prerë. Në rastin kur Gjykata Administrative e Apelit pranon ankimin e kandidatit/kandidatëve dhe

shfuqizon vendimin, Këshilli, brenda dy javëve nga njoftimi i vendimit gjyqësor, rishikon vendimin e tij në masën e nevojshme për zbatimin e vendimmarrjes së gjykatës. Vendimi i formës së prerë për renditjen e kandidatëve dhe vendimi paraprak i propozimit për emërim, bëhen publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

7.1.3 Vendimi për ngritjen në detyrë

Jo më vonë se 7 ditë nga marrja formë të prerë sipas ligjit të vendimit për renditjen e kandidatëve në një procedurë përzgjedhjeje për ngritjen në detyrë, mbi projektvendimin e përgatitur nga relatori i asaj procedure, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në atë pozicion të lirë të kandidatit të renditur më lart. Në rastin e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë në GjL, për më shumë se një pozicion të lirë, Këshilli merr vendim për ngritjen në detyrë në ato pozicione të lira të kandidatëve të renditur më lart. Vendimi i Këshillit për ngritjen në detyrë i njoftohet kandidatit të ngritur në detyrë, gjykatës respektive, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

7.1.4 Vendimi përfundimtar i propozimit për emërim në Gjykatën e Lartë

Vendimi përfundimtar i Këshillit për propozim për emërim në Gjykatën e Lartë i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit. Në rastin kur Presidenti i Republikës nuk shprehet brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të Këshillit, kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit, pas bërjes, gjatë këtij afati, të ceremonisë së betimit përpara Presidentit të Republikës.

Në rastin kur Presidenti i Republikës dekreton mosemërimin në Gjykatën e Lartë të kandidatit të propozuar, ky dekret shqyrtohet nga Këshilli, jo më vonë se një javë nga depozitimi i tij pranë Këshillit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij voton shumica e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, jo më pak se gjashtë anëtarë. Në këtë rast kandidati i propozuar shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit, pas bërjes, gjatë këtij afati, të ceremonisë së betimit përpara Presidentit të Republikës.

Nëse Dekreti i Presidentit të Republikës mbetet në fuqi, Këshilli, në të njëjtën mbledhje, vendos për rihapjen e procesit të kandidimit të gjyqtarëve për atë pozicion të lirë në Gjykatën e Lartë ose propozon për emërim kandidatin e renditur i dyti më lart, propozim ky që i dërgohet menjëherë Presidentit të Republikës.

7.2 Monitorimi i procedurave të ngritjes në detyrë dhe ushtrimit nga ana e tyre i të drejtave procedurale

- Veprimet procedurale të relatorit në lidhje me administrimin e dosjes, përgatitjen e relacionit, projektvendimit, koordinimit të brendshëm dhe njoftimit.

- Evidentimi i rasteve të deklaruara apo jo të konfliktit të interesit dhe veprimet e ndërmarra nga relatori, komisioni dhe këshilli për rastin në fjalë.
- Evidentimi i rasteve kur evidentohet informacion i paplotë në dosjen e kandidatit dhe komunikimeve mes relatorit dhe kandidatit.
- Kohëzgjatja e veprimeve procedurale nga ana e relatorit nga fillimi i procedurës së kandidimit deri në përfundim të procedurës së përzgjedhjes.
- Koha në dispozicion për njohjen e çështjes nga komisioni dhe nga këshilli.
- Afatet e njoftimit të datës së mbledhjes së Këshillit dhe relacionit të përgatitur nga relatori kandidatëve.
- Afatet për shqyrtimin e dokumentacionit plotësues, datës së seancës shtesë dhe procedurës së votimit të projektvendimit nga këshilli.
- Afatet e publikimit të vendimit paraprak për emërim nga KLGj-ja në faqen e internetit.

Monitorimi i respektimit të afateve procedurale të shqyrtimit të dokumentacionit të kandidimit nga relatori

- Respektimi i afatit 7-ditor për caktimin e relatorit: PO/JO
- Respektimi i afatit 5-ditor për dhënien e sqarimeve dhe bërjen e plotësimeve në dosje nga ana e kandidatit PO/JO
- Respektimi i afatit 7-ditor për seancën e plotësimit të dokumentacionit nga relatori PO/JO
- Respektimi i afatit 10-ditor për arsyetimin e vendimit nga relatori PO/JO

Monitorimi i respektimit të afateve të ankimit

- Monitorimi i afatit 5-ditor të ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit;
- Monitorimi i kohëzgjatjes së shqyrtimi gjyqësor administrativ 2-javor;
- Afatet e rishikimit të vendimit nga ana e KLGj-së në rastet e pranimit të ankimit nga GjAA (2 javë).

8. PYETJE DHE ÇËSHTJE PËR DISKUTIM

Moduli 1: Pyetje në lidhje me treguesit e monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor

Disa nga treguesit për monitorim në lidhje me zbatimin e kuadrit të posaçëm ligjor në lidhje me GjL-në mund të hartohen përmes pyetjeve të mëposhtme:

1. A u krijua GjL-ja brenda periudhës tranzitore të parashikuar nga ligji?
2. A ka gjykata numrin e gjyqtarëve të përcaktuar në ligj?
3. Si është aktualisht përbërja e gjykatës?
3. Sa kandidatë aplikuan mesatarisht për një pozicion të lirë pranë GjL-së në 2020-2023? Nga cilat gjykata erdhën kandidatët e emëruar?

Moduli 2: Pyetje në lidhje me treguesit e monitorimit të zbatimit të kuadrit ligjor

1. Cilat janë kushtet që kandidati për t'u ngritur në detyrë pranë GjL-së duhet të plotësojë për të lejuar kandidimin e tij?
2. Cilat janë disa nga kushtet që duhet të plotësohen për verifikimin e kritereve ligjore? Cilët janë aktorët që ofrojnë informacion në lidhje me kandidatin?
4. Sa është numri i kandidatëve për çdo pozicion? Sa prej tyre janë skualifikuar për mospërbushje të kritereve ligjore?
5. Sa është numri i ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave (në rastet kur KLGj-ja gjykon se kandidatët nuk i plotësojnë kushtet)?
6. Cilat janë rezultatet e ankimeve kundër vendimeve të KLGj-së për mospranimin e kandidaturave?
7. Cilat nga kriteret ligjore rezultojnë më problematike për t'u plotësuar në këtë fazë?

Moduli 3: Pyetje dhe shembuj në lidhje me hapat, kriteret dhe përparësitë e renditjes së kandidatëve

1. Cilat janë hapat dhe përparësia që vendos ligji në lidhje me renditjen e kandidatëve?
2. Rendisni sipas përparësisë: vjetësinë në punë, vlerësimin etik dhe profesional, përvojat e veçanta të punës si gjyqtar dhe ato profesionale në fushën penale?

3. Çfarë kuptojmë me “Përvojë në pozicionet e komanduara”?

Shembull 1: dy kandidatë kanë vlerësimet e fundit shkëlqyeshëm dhe vlerësimin e parafundit shumë mirë, por kandidati 2 ka përvojë si gjyqtar i komanduar, ndërsa gjyqtari 1 ka 5 vjet më shumë përvojë profesionale. Cili nga kandidatët do të renditet më lart?

Shembull 2: Cili nga kandidatët do të renditet më lart?

- Kandidati 1 ka një vlerësim shkëlqyeshëm dhe një vlerësim shumë mirë, ka përvojë 3 vjet i komanduar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe vjetërsi në punë 10 vjet.
- Kandidati 2 ka dy vlerësimet e fundit shkëlqyeshëm, nuk ka përvojë komandimi, ka përvojë në punë si gjyqtar 15 vjet.

Moduli 4: Procedurat e ngritjes në detyrë, garancitë për kandidatin

1. Cilat janë fazat e procedurës së përzgjedhjes për ngritjen në detyrë? Kush është aktori (ët) që luan rolin kryesor në secilën nga këto faza?
2. Në cilat nga fazat e mësipërme kandidati mund të ushtrojë të drejtën e ankimit dhe para cilës instancë administrative apo gjyqësore?
3. Cili është roli i dekretit të presidentit për emërimin në detyrë të gjyqtarit të GjL-së? Çfarë ndodh nëse presidenti nuk e emëron gjyqtarin e caktuar nga KLGj-ja?

9. EKSTRAKTE NGA LEGJISLACIONI

KUSHTETUTA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË (Ndryshuar me ligjet: nr. 9675, datë 13.01.2007, nr. 9904, datë 21.04.2008, nr. 88/2012, datë 18.09.2012, nr. 137/2015, datë 17.12.2015, nr. 76/2016, datë 22.07.2016, nr. 115/2020, datë 30.07.2020)

PJESA E NËNTË GJYKATAT

Neni 135 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016)

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.
3. Kuvendi mund të krijojë me ligj gjykata të tjera për fusha të veçanta, por në asnjë rast gjykata të jashtëzakonshme.
4. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme që parashikohen në paragrafin 2, të këtij neni, emërohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, sipas ligjit. Gjyqtarët e gjykatave të posaçme shkarkohen nga detyra me dy të tretat e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Kandidatët për gjyqtarë dhe nëpunës civilë gjyqësorë në gjykatat e posaçme, si dhe familjarët e afërm të kandidatëve, para emërimit, i nënshtrohen verifikimit të pasurisë dhe të figurës, si dhe japin pëlqimin për kontrollin periodik të llogarive të tyre bankare dhe të telekomunikimeve vetjake, sipas ligjit.

Neni 136 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë emërohen nga Presidenti i Republikës, me propozim të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për një mandat 9-vjeçar, pa të drejtë riemërimi.
2. Presidenti i Republikës, brenda 10 ditëve nga data e marrjes së vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, emëron gjyqtarin e Gjykatës së Lartë, me përjashtim të rasteve kur Presidenti konstaton se kandidati nuk plotëson kriteret e kualifikimit ose kushtet e zgjedhshmërisë,

sipas ligjit. Dekreti i Presidentit të Republikës për mosemërimin e kandidatit humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Në këtë rast, si dhe kur Presidenti nuk shprehet, kandidati shpallet i emëruar dhe fillon detyrën brenda 15 ditëve nga data e vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë zgjidhet nga radhët e gjyqtarëve me të paktën 13 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit. Një e pesta e gjyqtarëve në këtë gjykatë përzgjidhet mes juristëve të spikatur me jo më pak se 15 vjet përvojë si avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, juristë të nivelit të lartë në administratën publike ose në fusha të tjera të së drejtës. Kandidatët që përzgjidhen nga radhët e juristëve duhet të kenë gradë shkencore në drejtësi.

4. Kandidati jo gjyqtar nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike, ose pozicione drejtuese në parti politike, gjatë 10 vjetëve të fundit para kandidimit. Kritere të tjera dhe procedura e përzgjedhjes së gjyqtarit parashikohen me ligj.

5. Gjyqtari i Gjykatës së Lartë qëndron në detyrë deri në emërimin e pasardhësit, përveç rasteve të parashikuara në nenin 139, paragrafi 3, nënparagrafët “c”, “ç”, “d” dhe “dh”.

Neni 139 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Mandati i gjyqtarit të Gjykatës së Lartë mbaron në rastet e mëposhtme: a) mbush moshën e pensionit; b) përfundon mandatin 9-vjeçar; c) jep dorëheqjen; ç) shkarkohet sipas parashikimeve të nenit 140 të Kushtetutës; d) vërtetohen kushtet e pazgjedhshmërisë dhe të papajtueshmërisë në ushtrimin e funksionit; dh) vërtetohet fakti i pamundësisë për të ushtruar detyrën.

2. Mbarimi i mandatit të gjyqtarit të Gjykatës së Lartë deklarohet me vendim të Gjykatës së Lartë.

3. Procedura për emërimin e gjyqtarit në një gjykatë tjetër pas përfundimit të mandatit rregullohet me ligj.

Neni 141 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.

2. Për ndryshimin e praktikës gjyqësore, Gjykata e Lartë tërheq për shqyrtim në Kolegjet e Bashkuara çështje të caktuara gjyqësore të vendosura nga kolegjet, sipas ligjit.

Neni 143 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundërshtues, me përjashtim të aktivitetit mësimdhënës, akademik, shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit.

Neni 147 (Ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor siguron pavarësinë, përgjegjshmërinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë.

Neni 147/a 34 (Shtuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016)

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor ushtron funksionet e mëposhtme: a) emëron, vlerëson, ngre në detyrë dhe transferon gjyqtarët e të gjitha niveleve; b) vendos për masat disiplinore ndaj gjyqtarëve të të gjitha niveleve; c) i propozon Presidentit të Republikës kandidatët për gjyqtarë të Gjykatës së Lartë, sipas ligjit; ç) miraton rregullat e etikës gjyqësore dhe mbikëqyr respektimin e tyre; d) drejton dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punës në administratën e gjykatave, me përjashtim të mbarëvajtjes së strukturave të teknologjisë së informacionit në gjykata, e cila rregullohet me vendim të Këshillit të Ministrave; dh) propozon dhe administron buxhetin e tij dhe të gjykatave; e) informon publikun dhe Kuvendin për gjendjen e sistemit gjyqësor; ë) ushtron funksione të tjera të caktuara me ligj.

2. Ligji mund të parashikojë krijimin e komisioneve vendimmarrëse pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor.

3. Ministri i Drejtësisë mund të marrë pjesë, pa të drejtë vote, në mbledhjet e Këshillit të Lartë Gjyqësor kur diskutohen çështje që lidhen me planifikimin strategjik dhe buxhetin e pushtetit gjyqësor.

LIGJ Nr. 115/2016 PËR ORGANET E QEVERISJES SË SISTEMIT TË DREJTËSISË

Neni 61 Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor organizohet dhe e ushtron veprimtarinë e tij në komisione ose në mbledhje plenare. Kompetencat e Këshillit që nuk përmenden në pikën 2, të këtij neni, ushtrohen nga komisionet. Kompetencat që përmenden në pikën 2, të këtij neni, ushtrohen nga mbledhja plenare, bazuar në propozimet e komisioneve përkatëse.

2. Mbledhja plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor ushtron kompetencat e mëposhtme: a) miraton akte nënligjore normative, në zbatim të këtij ligji ose të ligjeve të tjera, me efekt të përgjithshëm detyrues mbi të gjithë gjyqtarët, administratën gjyqësore, personat privatë dhe organet publike; b) miraton akte për rregullimin e procedurave të brendshme të Këshillit; c) emëron dhe ngre në detyrë gjyqtarët mbi propozimin e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës; ç) vendos masën disiplinore të shkarkimit mbi gjyqtarët e Gjykatës së Posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar me dy të tretat e votave mbi propozimin e Komisionit Disiplinor; d) shqyrton ankimet kundër vendimeve të komisioneve, me përjashtim të atyre vendimeve që rrëzojnë vendimet e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimeve ose pushimin e hetimeve, sipas pikës 14, të nenit 62, të këtij ligji; dh) miraton

udhëzime të përgjithshme jodetyruese; e) miraton rregulla të detajuara për funksionimin e administratës së Këshillit; ë) miraton përbërjen e komisioneve të përhershme, të komisioneve të përkohshme, si dhe rregulla të detajuara për veprimtarinë e tyre.

3. Në mbledhjen plenare marrin pjesë të gjithë anëtarët e Këshillit. Një anëtar i Këshillit nuk merr pjesë në vendimmarrjen e mbledhjes plenare për çështje të mëposhtme të rendit të ditës: a) në rast vendimi për çështje disiplinore, kur anëtari ka paraqitur tek Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkesën, mbi bazën e së cilës ka nisur procedimi disiplinor; b) nëse si anëtar i komisionit ka marrë vendim për një çështje disiplinore, të parashikuar në pikën 13, të nenit 62, të këtij ligji.

Neni 62 Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Komisionet e përhershme të Këshillit të Lartë Gjyqësor e ushtrojnë veprimtarinë dhe marrin vendime në fushat e parashikuara në pikën 3, të këtij neni, ose i propozojnë mbledhjes plenare të Këshillit miratimin e vendimeve që janë në kompetencë të kësaj të fundit, sipas nenit 61 të këtij ligji.

2. Pasi zgjedh Kryetarin, Këshilli merr vendim për përbërjen e komisioneve të përhershme, përfshirë edhe anëtarët zëvendësues. Në çdo rast një anëtar gjyqtar mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar gjyqtar. Një anëtar jogjyqtar mund të zëvendësohet vetëm nga një tjetër anëtar jogjyqtar. Procedura dhe kritere më të hollësishme për marrjen e këtij vendimi rregullohen nga Këshilli.

3. Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në përbërje komisionet e përhershme si më poshtë: a) Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit; b) Komisioni Disiplinor; c) Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale; ç) Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

4. Çdo Komision përbëhet nga tre anëtarë. Pranë çdo komisioni caktohen edhe 2 anëtarë zëvendësues. Caktimi i anëtarëve dhe anëtarëve zëvendësues të komisioneve bëhet duke mbajtur parasysh nevojën për të garantuar një shpërndarje të drejtë të ngarkesës së punës dhe respektimin e kërkesave dhe të raporteve midis anëtarëve gjyqtarë dhe jogjyqtarë, të parashikuara në pikat 5 deri në 12, të këtij neni, dhe, për aq sa është e mundur, preferencat e anëtarëve.

5. Një anëtar i Këshillit mund të jetë anëtar në jo më shumë se 2 komisione të përhershme. Një anëtar i Këshillit nuk mund të jetë kryetar në më shumë se 1 komision të përhershëm. Ky rregull nuk zbatohet për anëtarët zëvendësues dhe për komisionet ad hoc.

6. Komisionet zgjedhin kryetarët përkatës në mbledhjen e tyre të parë me shumicë votash dhe bazuar në propozimin e Kryetarit të Këshillit. Kryetari i Këshillit është kryetar i komisioneve ku ai merr pjesë.

7. Anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale nuk mund të jenë edhe anëtarë të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës.

8. Komisioni i Planifikimit Strategjik, Administrimit dhe Buxhetit përbëhet nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar.
9. Komisioni Disiplinor përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.
10. Komisioni i Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.
11. Komisioni i Zhvillimit të Karrierës përbëhet nga 2 anëtarë gjyqtarë dhe 1 anëtar jogjyqtar.
12. Anëtarët e komisioneve i ushtrojnë funksionet e tyre pranë komisioneve për dy vite e gjysmë nga dita e zgjedhjes. Në përfundim të kësaj kohe përbërja e komisioneve ndryshohet sipas procedurës të parashikuar në pikën 2 të këtij neni.
13. Për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për arkivimin e ankimit ose pushimin e hetimit ndaj një gjyqtari, krijohet një komision i përkohshëm i përbërë nga 2 anëtarë jogjyqtarë dhe 1 anëtar gjyqtar. Përbërja e këtij komisioni përcaktohet me short nën kujdesin e Kryetarit të Këshillit. Vendimet e komisionit të përkohshëm janë përfundimtare dhe nuk mund të apelojnë para mbledhjes plenare të Këshillit.
14. Këshilli i Lartë Gjyqësor mund të krijojë komisione të përkohshme për trajtimin e çështjeve të veçanta.
15. Komisionet vendosin me shumicën e votave në prani të të gjithë anëtarëve.
16. Brenda muajit janar të çdo viti kalendarik, secili komision i përhershëm paraqet në mbledhjen plenare të Këshillit raportin vjetor të veprimtarisë me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse. Raporti bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit.

Neni 63 Relatori

1. Në të gjitha rastet kur mbledhja plenare ose komisionet e Këshillit të Lartë Gjyqësor shqyrtojnë dhe miratojnë akte administrative individuale në lidhje me statusin profesional të 36 gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, njëri nga anëtarët e komisionit shërben si relator.
2. Secili nga anëtarët e komisionit, përfshirë edhe kryetarin e komisionit, mund të jetë relator. Relatori caktohet me short, duke marrë parasysh ngarkesën dhe aftësitë e secilit anëtar sipas procedurës dhe rregullave më të hollësishme të miratuara nga Këshilli. Kyetari i Këshillit nuk mund të jetë relator.
3. Relatori kujdeset për zhvillimin e procedimit administrativ individual dhe sidomos për sa më poshtë:
 - a) shqyrtimin e dokumentacionit të depozituar nga subjektet e procedurës administrative;
 - b) përgatitjen e projektaktit administrativ;
 - c) koordinimin me kryetarin e komisionit për përgatitjen e mbledhjes së komisionit;
 - ç) koordinimin me Kryetarin e Këshillit për përgatitjen e mbledhjes plenare të Këshillit;
 - d) njoftimet për subjektet e procedimit administrativ.

4. Në ushtrimin e përgjegjësive të tij relatori ndihmohet nga personeli administrativ i Këshillit të Lartë Gjyqësor.

Neni 65 E drejta për të kërkuar informacion

1. Çdo organ publik, person fizik ose juridik bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor duke i vënë në dispozicion informacione ose dokumente, të cilat i nevojiten Këshillit për ushtrimin e funksioneve të tij. 2. Çdo organ publik, person fizik ose juridik paraqitet ose dërgon përfaqësues në mbledhjet plenare ose të komisioneve të Këshillit për të paraqitur prova dhe dëshmuar në lidhje me çdo çështje që lidhet me ushtrimin e funksioneve të Këshillit.

SEKSIONI 2 MBLEDHJA PLENARE E KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

Neni 66 Thirrja e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor mblidhet sa herë është e nevojshme, por jo më pak se 1 herë në muaj.
2. Kryetari i Këshillit vendos për datën dhe orarin e mbledhjeve.
3. Kryetari mund të thërrasë mbledhje të tjera kur ai vlerëson se ato janë të nevojshme për veprimtarinë e Këshillit.
4. Mbledhja e Këshillit mund të thirret edhe me kërkesën e jo më pak se 3 anëtarëve të Këshillit, të cilët përcaktojnë në kërkesë edhe çështjet që do të diskutohen në mbledhje. Kryetari vendos datën dhe orarin e mbledhjes jo më vonë se 7 ditë nga dita e paraqitjes së kërkesës.
5. Kryetari siguron respektimin e procedurave për njoftimin me shkrim të çdo anëtari jo më vonë se 7 ditë përpara çdo mbledhjeje të Këshillit.
6. Njoftimi shoqërohet me rendin e ditës, projektvendimet që propozohet të merren gjatë mbledhjes, së bashku me çdo të dhënë, projektakt, këshillë ligjore, si dhe çdo informacion apo dokument tjetër, i cili do të merret në shqyrtim në mbledhje apo i cili u shërben diskutimeve në mbledhje.
7. Rregullat e parashikuara në pikën 6, të këtij neni, nuk përbëjnë pengesë për të miratuar kërkesa për ndryshimin e përmbajtjes së një projektvendimi që shoqëron rendin e ditës.
8. Çdo vendim i Këshillit, që përbën akt administrativ individual në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, nënshkruhet nga çdo anëtar i pranishëm në mbledhje, siç është rënë dakord. Refuzimi i një anëtari për të nënshkruar përmbajtjen e vendimit nuk përbën shkak për pavlefshmërinë e aktit. Aktet e tjera nënshkruhen nga Kryetari i Këshillit.
9. Në rastet kur Këshilli merr vendime administrative individuale në lidhje me statusin profesional të gjyqtarëve të veçantë ose të zyrtarëve të veçantë të administratës gjyqësore, anëtari i mbetur në

pakicë mund të kërkojë që opinionin e tij t'i bashkëngjitet vendimit të Këshillit. Në këtë rast, anëtari është përgjegjës për hartimin dhe dorëzimin e opinionit të pakicës brenda afatit të caktuar nga Këshilli për zbardhjen e vendimit.

Neni 67 Rendi i ditës

1. Kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor vendos rendin e ditës së mbledhjes së Këshillit.
2. Një çështje e caktuar i shtohet rendit të ditës kur kjo i kërkohet me shkrim Kryetarit jo më vonë se 4 ditë përpara mbledhjes nga të paktën 3 anëtarë të Këshillit.
3. Nëse të paktën 6 anëtarë të pranishëm në një mbledhje të Këshillit vendosin se një çështje, e cila nuk ishte përfshirë në rendin e ditës, duhet të diskutohet, si dhe t'i jepet zgjidhje në mbledhje, çështja i shtohet rendit të ditës.

Neni 68 Kuorumi dhe vendimmarrja në Këshillin e Lartë Gjyqësor

1. Pjesëmarrja në mbledhjet plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është e detyrueshme. Në çdo rast, kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjeve plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor është kur në to marrin pjesë jo më pak se 7 anëtarë.
2. Këshilli i Lartë Gjyqësor vendos me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur.
3. Anëtari i Këshillit, i pranishëm në mbledhje, nuk mund të heqë dorë nga votimi, me përjashtim të rasteve kur ekzistojnë pengesa ligjore të tilla si konflikti i interesit ose pengesa të tjera në zbatim të këtij ligji, të ligjit për konfliktin e interesave ose të Kodit të Procedurave Administrative.
4. Administrata mban shënim e regjistron votat e anëtarëve të Këshillit.
5. Kryetari është anëtari i fundit, i cili voton në lidhje me një çështje. 6. Kur votat ndahen në mënyrë të barabartë, vota e kryetarit është përcaktuese.
6. Çdo anëtar i Këshillit mban përgjegjësi për votën dhe ka të drejtë të bëjë një deklaram të shkurtër me gojë ose me shkrim për arsyet e votimit.

Neni 69 Dokumentimi i mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

1. Kryetari është përgjegjës për të siguruar që administrata të marrë të gjitha masat e nevojshme që çdo mbledhje plenare e Këshillit të Lartë Gjyqësor të dokumentohet në mënyrë të përshtatshme përmes: a) regjistrimit audio; b) procesverbalit me përmbledhjen e diskutimeve.
2. Regjistrimi audio i mbledhjes plenare bëhet publik në faqen zyrtare të Këshillit brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes. Përpara publikimit, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata

kujdeset për redaktimin e materialit, duke fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

3. Procesverbali me përmbledhjen e diskutimeve bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit pasi miratohet nga mbledhja plenare pasardhëse e Këshillit. Edhe në këtë rast, nën përgjegjësinë e kryetarit, administrata kujdeset për të fshirë çdo referencë tek emrat konkretë, përveç emrave të anëtarëve të Këshillit dhe emrave të gjyqtarëve, mbi të cilët janë vendosur masa disiplinore të pezullimit dhe të shkarkimit.

4. Nën drejtimin dhe mbikëqyrjen e kryetarit, administrata mban procesverbalin me përmbledhjen e diskutimeve të çdo mbledhjeje, duke shënuar të paktën informacionet e mëposhtme: a) anëtarët e pranishëm në diskutim për çdo çështje të rendit të ditës; b) çështjet e rendit të ditës, përfshirë çështjet e shtuara sipas nenit 67, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji; c) dorëheqjet e anëtarëve të Këshillit dhe arsyetimet përkatëse; ç) aspektet kryesore të çështjeve të diskutuara dhe propozimet për vendime; d) rezultatin e votimit, mënyrën e votimit të secilit anëtar dhe arsyetimin e votimit nga secili anëtar; dhe dh) vendimet. 5. Procesverbalet me draftin e përmbledhjes së diskutimeve të mbledhjes nënshkruhen nga kryetari dhe u vihen në dispozicion të gjithë anëtarëve brenda 5 ditëve nga dita e mbledhjes.

6. Çdo anëtar i Këshillit që ishte i pranishëm në mbledhje mund të vërë në dukje pasaktësi në përmbajtjen e procesverbalit të përmbledhur dhe t'i kërkojë kryetarit, me anë të një kërkesë me shkrim, korrigjimin e tij. Në qoftë se regjistrimi konfirmon pasaktësinë e zbardhjes, përmbledhja e procesverbalit të mbledhjes së Këshillit korrigjohet në mënyrat e mëposhtme: a) me urdhër të kryetarit, bazuar në kërkesën e paraqitur, sipas pikës 6 të këtij neni; ose b) me vendim të Këshillit në mbledhjen pasuese.

7. Administrata merr masat që regjistrimet audio të mbledhjeve të Këshillit dhe procesverbali i përmbledhur të ruhen për jo më pak se 10 vjet, në përputhje me ligjin "Për arkivat".

Neni 70 Zbatimi me analogji i rregullave për komisionet e Këshillit 1. Rregullimet e neneve 66 deri 69, të këtij ligji, për thirrjen e mbledhjes, rendin e ditës, kuorumin, vendimmarrjen dhe dokumentimin e mbledhjes plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor zbatohen, për aq sa është e mundur dhe me ndryshimet përkatëse, edhe për mbledhjet e komisioneve të Këshillit të Lartë Gjyqësor. 2. Këshilli i Lartë Gjyqësor miraton rregulla të detajuara për organizimin dhe funksionimin e komisioneve.

LIGJ Nr. 96/2016 PËR STATUSIN E GJYQTARËVE DHE PROKURORËVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 1 Objekti i ligjit

1. Objekti i këtij ligji është përcaktimi i statusit të magistratëve, duke parashikuar rregulla në lidhje me: a) të drejtat dhe detyrimet e tyre; b) pranimin dhe emërimin e tyre; c) zhvillimin

e karrierës dhe mbarimin e mandatit të tyre; ç) vlerësimin etik dhe profesional të tyre; d) përgjegjësinë disiplinore, penale dhe civile të tyre;

2. Sipas parashikimeve të këtij ligji, statusi gëzohet ligjërisht nga një person që sapo emërohet në funksion dhe përfundon me mbarimin e statusit të magjistratit.

KREU II PAPAJTUESHMËRITË, KUFIZIMET DHE VEPRIMTARITË E TJERA

Neni 6 Papajtueshmëritë me funksionin e magjistratit

1. Funksioni i magjistratit është i papajtueshëm me: a) anëtarësinë në parti politike dhe pjesëmarrjen në veprimtari politike të organizuara nga një parti politike; b) kryerjen e çdo veprimtarie politike, pavarësisht nëse veprimtaria kryhet në bashkëpunim me ndonjë parti politike ose jo, që mund të ndikojë në pavarësinë e magjistratit, të krijojë ndonjë konflikt interesi ose, në çdo rast, të krijojë përshtypjen që magjistrati është i paanshëm dhe i pandikuar.

2. Kryetari njofton Këshillin në rast se ka dyshime të bazuara për të besuar se një magjistrat i gjykatës ose prokurorisë përkatëse nuk i përmbush kërkesat e kësaj dispozite.

PJESA III

ZHVILLIMI I KARRIERËS SË MAGJISTRATËVE

KREU I

REKRUTIMI I KANDIDATËVE MAGJISTRATË

Neni 28 Kriteret e pranimit në formimin fillestar

Çdo person ka të drejtë të kandidojë në Shkollën e Magjistraturës, për t'u pranuar në formimin fillestar për magjistrat, nëse përmbush njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) ka zotësi të plotë për të vepruar;

b) është shtetas shqiptar;

c) ka përfunduar, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, ciklin e dytë të studimeve universitare për drejtësi, me diplomë "Master i shkencave", si dhe ka dhënë provimin e shtetit për jurist në Shqipëri, ose ka kryer, me pikët minimale të përcaktuara nga Shkolla e Magjistraturës, studimet universitare për drejtësi në një vend anëtar të Bashkimit Europian dhe ka marrë një diplomë të barasvlershme, e njësuar sipas rregullave për njësimin e diplomave të parashikuar me ligj;

ç) ka të paktën tre vjet përvojë profesionale aktive me kohë të plotë, në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në administratën publike, profesionet e lira ligjore, mësimdhënie në fakultetet e drejtësisë, ose në çdo pozicion tjetër të barasvlershëm me to, në sektorin privat

ose organizatat ndërkombëtare;

d) nuk është dënuar me vendim penal të formës së prerë;

dh) nuk është larguar nga detyra për shkaqe disiplinore, si dhe nuk ka masë disiplinore në fuqi;

e) nuk është anëtar i partive politike në kohën e kandidimit;

ë) nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990;

f) nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

KREU V NGRITJA NË DETYRË

Neni 47 Kriteret minimale të përvojës profesionale për ngritjen në detyrë

1. “Ngritja në detyrë” është kalimi nga: a) një pozicion në sistemin gjyqësor ose të prokurorisë, në një pozicion tjetër të një niveli më të lartë; b) një pozicion i juridiksionit të përgjithshëm civil, penal ose administrativ në një pozicion në një prej gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar ose në Prokurorinë e Posaçme; c) një pozicion si magjistrat, në pozicionin e kryetarit të një gjykate ose prokurorie; ç) një pozicion i komanduar ose pozicion në skemën e delegimit, në një pozicion të një niveli më të lartë sesa pozicioni i mbajtur para komandimit.

2. Magjistrati ngrihet në detyrë nëse plotëson këto kriteret minimale për përvojën profesionale: a) për pozicionin gjyqtar në gjykatën e posaçme të shkallës së parë për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar në fushën e drejtësisë kriminale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) për pozicionin gjyqtar apeli në Gjykatën e Posaçme të Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin jo më pak se dhjetë vjet si gjyqtar, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale ose si inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; c) për pozicionin prokuror në Prokurorinë e Posaçme, magjistrati duhet të ketë ushtruar funksionin për jo më pak se dhjetë vjet si prokuror, duke përfshirë edhe përvojën si prokuror i komanduar.

3. Për të gjitha pozicionet e përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, magjistrati duhet të përmbushë edhe kriteret e tjera dhe kushtet e sigurisë, të parashikuara në ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

4. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë gjykatave ose prokurorive të shkallës së dytë, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se shtatë vjet në shkallën e parë, nga

të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

5. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë në pozicione pranë Gjykatës së Lartë dhe Prokurorisë së Përgjithshme, nëse ka ushtruar funksionin jo më pak se trembëdhjetë vjet në nivele më të ulëta, nga të cilat të paktën pesë vjet në fushën e së drejtës përkatëse të përshtatshme për pozicionin e lirë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar.

6. Magjistrati mund të ngrihet në detyrë, në pozicionin e kryetarit të gjykatës ose prokurorisë së shkallës së parë ose të dytë, nëse: a) ka ushtruar funksionin e magjistratit jo më pak se shtatë vjet, gjatë të cilës, të paktën katër vjet në të njëjtën shkallë, duke përfshirë edhe përvojën si magjistrat i komanduar; b) përmbush treguesit e kërkuar për aftësi organizative dhe drejtuese, të tilla si: i) përvoja si zëvendëskryetar, kryetar i një seksioni ose magjistrat për çështjet e shtypit; ii) përvoja në pozicione drejtuese në administratën publike ose të drejtësisë, ose përvoja si anëtar i Këshillit, që ka përfunduar të paktën në tre vjet më parë; iii) njohuri për strukturat organizative dhe modele të ndryshme të drejtimit, si magjistrat në skemën e delegimit ose inspektor në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; c) nuk ka qenë anëtar i Këshillit në tre vitet e fundit.

Neni 48 Ngritja në detyrë në shkallët më të larta ose të specializuara

1. Pozicionet në Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme dhe gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar plotësohen nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë. Pozicionet në gjykatat e tjera të apelit plotësohen nëpërmjet procedurave të lëvizjes paralele, në përputhje me nenet 42 dhe 43 të këtij ligji.

2. Në rastin kur ka shumë pozicione të lira, të cilat nuk plotësohen me lëvizje paralele, secili Këshill organizon një procedurë ngritje në detyrë për çdo pozicion të lirë, të paktën një herë në çdo tre muaj. Pozicionet plotësohen jo më vonë se tre muaj nga dita e shpalljes së procedurës.

3. Këshillat shpallin procedurën e ngritjes në detyrë dhe bëjnë thirrje që të kandidojë: a) magjistrati që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur; b) magjistrati i komanduar ose magjistrati në skemën e delegimit që plotëson kriteret për ngritjen në detyrë, në përputhje me kërkesat e pozicionit të lirë të shpallur; c) juristi i spikatur, sipas përcaktimeve të nenit 49 të këtij ligji.

4. Kandidati që ka ushtruar funksionin si anëtar i Këshillit, përjashtohet nga procedura e ngritjes në detyrë gjatë kohës së ushtrimit të funksionit si anëtar, si dhe tre vjet pas mbarimit të mandatit.

5. Në zbatim të pikës 3, të këtij neni, shpallja publikohet të paktën në faqen zyrtare të Këshillit dhe duhet të përmbajë informacionin e nevojshëm për pozicionin e lirë, si dhe të përcaktojë: a) afatin e kandidimit, i cili është të paktën dy javë nga data e shpalljes së procedurës; b) informacionin dhe dokumentacionin që i bashkëlidhet kandidimit; c) procedurën e

kandidimit dhe vendin e dorëzimit të dokumentacionit.

6. Pas shpalljes së procedurës së ngritjes në detyrë, kandidati mund të kandidojë për jo më shumë se tre pozicione të lira ose pozicione që priten të bëhen të lira. Nëse magjistrati kandidon për më shumë se një pozicion, ai bën renditjen e tyre sipas preferencës.

7. Këshilli verifikon kandidatët, sipas parashikimeve të pikave 2 deri në 7, të nenit 32, të këtij ligji.

8. Vetëm kandidatët të cilët kalojnë verifikimin e pasurisë dhe figurës dhe që nuk kanë masa disiplinore në fuqi, pranohen në procedurat e mëtejshme të ngritjes në detyrë.

9. Këshillat shqyrtojnë kandidimet dhe rendisin kandidatët që përmbushin kriteret, sipas rezultateve të mëposhtme: a) së pari, dy vlerësimet e mëparshme, duke pasur parasysh: i) që përvoja në pozicionet e komanduara, si magjistrat në skemën e delegimit, ose si anëtar i Këshillit që i ka mbaruar mandati tre vite përpara kandidimit do të ketë përparësi; ii) në rastet e më shumë kandidatëve me rezultate të njëjta, magjistratët brenda grupit të kandidatëve me rezultatet më të larta të vlerësimit do të renditen sipas skemës së pikëve, të përcaktuar nga Këshilli i Lartë i Gjyqësor; b) së dyti, në rast se pas vlerësimit të bërë sipas shkronjës “a”, të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë, sipas përvojës profesionale specifike që kërkohet për pozicionin e lirë; c) së treti, në rast se pas vlerësimit të bërë, sipas shkronjës “b”, të pikës 9, të këtij neni, ka më shumë se një kandidat me pikë më të larta, Këshilli rendit këta kandidatë sipas vjetërsisë si magjistrat ose jurist.

10. Këshillat vendosin të ngrenë në detyrë kandidatët e vlerësuar me pikët më të larta të arritura, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14, të këtij neni. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim.

11. Për procedurën e ngritjes në detyrë, për plotësimin e një pozicioni të lirë në Gjykatën e Lartë, Këshilli i Lartë Gjyqësor propozon me shkrim emërimin e kandidatëve që plotësojnë kriteret ligjore, duke arsyetuar përmbushjen e kriterëve dhe duke bërë renditjen e kandidatëve, sipas procedurës dhe rregullave të parashikuara në pikat 9 dhe 14 të këtij neni.

12. Propozimi për emërimin është i ankimueshëm. Rregullat e parashikuara në nenin 41, pikat 2 deri në 4, aplikohen për aq sa gjejnë zbatim. Këshilli bën publik vendimin përfundimtar të propozimit për emërim në faqen e tij zyrtare. Vendimi i këshillave për mosçaktivimin në detyrë në gjykatat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe Prokurorinë e Posaçme është i formës së prerë.

13. Ngritja në detyrë e gjyqtarit me renditjen më të lartë dekretohet nga Presidenti i Republikës, në përputhje me nenin 136, pika 2, të Kushtetutës.

14. Këshillat miratojnë rregulla më të detajuara, të cilat përcaktojnë: a) kriteret për etikën dhe veprimtarinë profesionale ndërmjet kandidatëve me pikë të barabarta vlerësimi; b) kriteret për vlerësimin e përvojës profesionale që kërkohet për pozicionin e lirë; c) procedurën që

ndiqet në rastin e pikëve të barabarta; ç) zbatimin dhe përshtatjen e parashikimeve të këtij neni për pozicionet e lira të përkohshme.

LIGJ Nr. 98/2016 PËR ORGANIZIMIN E PUSHTETIT GJYQËSOR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Neni 3 Llojet e gjykatave

1. Pushteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit dhe gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.
2. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm janë gjykata me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë dhe gjykata me juridiksion të përgjithshëm të apelit. Gjykatat me juridiksion të përgjithshëm të shkallës së parë mund të kenë degë.
3. Gjykata të posaçme janë: a) gjykatat administrative të shkallës së parë dhe Gjykata Administrative e Apelit; b) Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë dhe e Apelit për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar.
4. Gjykata e Lartë gjykon çështje të juridiksionit të përgjithshëm dhe të posaçëm.

KOMPETENCAT TOKËSORE DHE JURIDIKSIONALE TË GJYKATAVE

Neni 10 Kompetencat tokësore të Gjykatës së Lartë

Gjykata e Lartë organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Gjykata e Lartë e ka selinë në Tiranë.

DISPOZITA TË VEÇANTA PËR GJYKATËN E LARTË

Neni 31 Kolegjet dhe trupat gjykues të Gjykatës së Lartë

1. Gjykata e Lartë organizohet në Kolegjin Civil, Kolegjin Penal dhe Kolegjin Administrativ. Kryetari i kolegjit zgjidhet nga anëtarët e tij me shumicë të thjeshtë votash për periudhën njëvjeçare, me të drejtë rizgjedhjeje.
2. Kolegji Civil shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm për çështje tregtare, civile dhe familjare, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Ai gjykon në trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë.
3. Kolegji Penal shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave me juridiksion të përgjithshëm dhe gjykatave të posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të

organizuar për çështje penale, si dhe çështje të tjera të caktuara në kompetencë me ligj. Ai gjykon në trupa gjykues të përbërë nga tre gjyqtarë. Çështjet penale të gjykuara nga gjykatat e posaçme për gjykimin e veprave penale të korrupsionit dhe krimit të organizuar gjykohen nga një trup gjykues i përbërë nga pesë gjyqtarë.

4. Kolegji Administrativ shqyrton rekurse ndaj vendimeve të gjykatave administrative. Trupat gjykues të Kolegjit Administrativ përbëhen nga tre gjyqtarë dhe për çështje që gjykojnë ligjshmërinë e akteve normative nënligjore trupat gjykues përbëhen nga pesë gjyqtarë.

5. Trupi gjykues kryesohet nga kryetari i gjykatës dhe në mungesë të tij nga kryetari i kolegjit. Në rast mungese të të dyve kryesohet nga gjyqtari relator.

KOMPETENCAT E ORGANEVE TË ADMINISTRIMIT GJYQËSOR

Neni 36 Kompetencat e Këshillit të Lartë Gjyqësor

Këshilli i Lartë Gjyqësor ka në kompetencë organizimin dhe funksionimin e shërbimeve, të cilat lidhen me administrimin gjyqësor; sipas kompetencave të parashikuara në ligjin “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”.

Neni 46 Marrëdhëniet me publikun

1. Shërbimet për marrëdhëniet me publikun kujdesen për informimin e publikut dhe medias në lidhje me veprimtaritë e gjykatës, si dhe për çështje të caktuara gjyqësore, në përputhje me rregullat e miratuara nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, me qëllim që: a) t'i sigurohet medias dhe publikut informacion faktik rreth vendimeve gjyqësore dhe për korrigjimin e gabimeve të mundshme mbi faktet për çështje të caktuara; b) t'i komunikohet medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes publik; c) të mbahen kontakte me median për seancat gjyqësore të çështjeve që kanë interes të veçantë publik; ç) të sigurohet informacion, në përputhje me ligjin “Për të drejtën e informimit”, në veçanti në lidhje me çështjet në gjykim dhe administratën gjyqësore; d) të publikohen të gjitha vendimet gjyqësore në përputhje me ligjin.

2. Shërbimet e marrëdhënies me publikun kryhen duke respektuar parimin për të drejtën e informimit, mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit dhe prezumimit të pafajësisë.

3. Shërbimi i marrëdhënies me publikun ndërvepron dhe bashkëpunon me Këshillin e Lartë Gjyqësor mbi ecurinë e marrëdhënies me publikun pranë gjykatave dhe kërkon mendimin e tij kur është e nevojshme.

4. Këshilli i Gjykatës cakton nëpunësin civil gjyqësor për marrëdhëniet me publikun si koordinator, në përputhje me ligjin për kompetencat e koordinatorit për të drejtën e informimit.

5. Shërbimet e marrëdhënies me publikun ushtrohen nga ose nën mbikëqyrjen e gjyqtarit të caktuar për marrëdhëniet me publikun.

10. BIBLIOGRAFIA

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë;
- Kodi i Procedurave Administrative;
- Ligji nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (Ligji për Qeverisjen);
- Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (Ligji për Statusin);
- Ligji nr. 98/2016 “Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 95/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”;
- Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;
- Ligji nr. 45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”
- Ligji nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 9367/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”;
- Ligji nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8678/2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8588/2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës së Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Ligji nr. 8480/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”;

- Vendimi i KLGj-së nr. 70/2020 “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”;
- Vendimi i KLGj-së nr. 75/2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”;
- Vendimi i KLGj-së nr. 102/2019 “Mbi kriteret e vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve jo gjyqtarë dhe procedurën e përzgjedhjes për emërim në Gjykatën e Lartë”;
- Vendimi i KLGj-së nr. 209, datë 11.10.2019 “Për miratimin e “metodologjia për vlerësimin dhe pikëzimin e kandidatëve jo gjyqtarë për në gjykatën e lartë”.
- Faqja e internetit të Gjykatës së Lartë.

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Meritokracia në karrierat gjyqësore : ngritja në detyrë e gjyqtarëve në Gjykatën e Posaçme të shkallës së parë për korrupsionin dhe krimin e organizuar dhe e gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë : manual trajnimi për shoqërinë civile / Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore. - Tiranë : Muza, 2024. [Vol.] 2, ... f. ; ... cm

ISBN 9789928361578

1.Gjykatës 2.Korrupsioni 3.Krime të organizuar

347.91(496.5)